



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
“Teknik laborator”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “REALD”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Vjollca Duro
2. Prof. As Gazment Koduzi

Dhjetor/2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Teknik laborator” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “REALD”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “REALD”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Teknik laborator”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër i MAS nr. 502, datë 06.09.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike (4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	6 PAE/3 PAK v.a. 2023-2024 8 PAE/6 PAK v.a. 2024-2025
18	Numri i studentëve:	8 studentë v.a. 2022- 2023 5 studentë v.a. 2023- 2024
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "REALD" (KUR), është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 650 datë 15.09.2011 si Akademia e Studimeve të Aplikuara "Reald", riorganizuar me UMAS Nr. 147, datë 31.03.2017, në Kolegji Universitar "REALD". Ai përbëhet nga 2 (dy) fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Mjeksore;
2. Fakulteti i Ekonomisë;

Programi i studimit Master i Shkencave në "Teknik laborator" është një program studimi që ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjeksore, Fakulteti i Shkencave Mjeksore. Programi është licensuar sipas Urdhërit të MAS. nr. 502, datë 06.09.2022 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave në "Teknik laborator" në Kolegjin Universitar "REALD"". Ky program studimi përmban 120 ECTS dhe është i organizuar në 2 (dy) vite akademike (4 semestra), dhe ofrohet në gjuhën shqipe.

Në përfundim të këtij program studimi lëshohet diplomë Master i Shkencave në: "Teknik laborator", referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Njësia bazë kryesore ku ofrohet programi i studimit është departamenti i Shkencave Mjeksore Teknike, si dhe Njësia kryesore Fakulteti i Shkencave Mjeksore që është përgjegjës për mbarëvajtjen, organizimin dhe cilësinë e programit duke kontribuar përmes katër departamenteve dhe strukturat e tjera, duke dhënë kontributin respektiv në realizimin e procesit akademik, shkencor dhe administrativ në funksion të programit të studimit. Në këtë fushë studimi Fakulteti ofron dhe programin Bachelor në Teknik laborator.

Ky program ka si objektiv të ofrojë personel të trainuar në teknikën laboratorike në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor. Ky program kontribuon në plotësimin e nevojave të tregut rajonal në Vlorë dhe Fier, por edhe në ato kombëtare.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit të parë për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Teknik laborator” ofruar nga Fakulteti i Shkencave Mjeksore (FSHM), Kolegji Universitar “REALD”. Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve të ciklit të dytë Master i Shkencave pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet, konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. (ascal.al) Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Procesi i vlerësimit është bazuar në Manualin e vlerësimit të miratuar nga ASCAL/BA dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga ASCAL sipas të cilave procesi i vlerësimit zgjat 6 muaj. Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga **Prof.Dr. Vjollca Duro** dhe **Prof.As. Gazmend Koduzi**. Koordinator Teknik e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Muhamed Prezja. Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.
- Vizita në KUR e zhvilluar në datat 10 dhe 11 Tetor 2024. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.



Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e FSHM. GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm studentëve dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu GVJ vlerëson edhe mbështetjen e ASCAL në këtë proces të parë të realizuar për këtë program studimi. Nga ana tjetër shprehim bindjen se ky akreditim i parë, gjetjet dhe konstatimet në këtë raport, do të vlejnjë institucionit të përmirësojë më tej programin e studimit.

GVJ dërgoi draft RVJ-në me datë 11.12.2024 nëpërmjet sistemit të ASCAL dhe Kolegji Universitar Reald ktheu përgjigje rreth draftit, me konstatimet e tyre në lidhje me përmbatjen e saj, me datë 13.12.2024.

GVJ pasi mori në konsideratë komentet e institucionit, shprehet si më poshtë:

- Në lidhje me ndryshimet që institucioni ka kryer në disa nga sylabuset që janë evidentuar nga GVJ me problematika, ata janë bërë pas komenteve të GVJ-së e për pasojë nuk e ndryshojnë gjykimin tonë, duke qenë se vlerësimi i këtij programi studimi bazohet në ecurinë e tij nga fillimi e deri në momentin që flasim. Gjithsesi mbështesim vullnetin e IAL-së për të ndërmarrë ndryshime në funksion të përmirësimit të programit të studimit.
- Në lidhje me konstatimet e IAL-së për stafin ndihmës akademik, GVJ e ndryshoi gjykimin e saj bazuar në evidencat shtesë, por i qëndron idesë që duhen shtuar më shumë staf ndihmës akademik në momentin që do të ndërtohen edhe laboratorët mjekësor mësimor në ambientet e kolegjit.
- Në lidhje me konstatimet e IAL-së për depozitimin e të gjithë marrëveshjeve të lidhura në funksion të programit të studimit, GVJ e ndryshoi mendimin e saj në bazë të evidencave shtesë, por sugjeron IAL-në që disa prej tyre duhet të rinovohen duke qenë se kanë kaluar afatet ligjore të funksionimit.
- Në lidhje me konstatimet e IAL-së mbi ngarkesën e stafit mësimor, GVJ gjykon se evidencat shtesë nuk arrijnë të ndryshojnë gjykimin e GVJ-së për këtë çështje. Kolegji Universitar REALD duhet të shtojë përpjekjet për të garantuar mbulimin 70% të ngarkesës mësimore nga personeli akademik efektiv.

GVJ duke marrë në konsideratë pikat më lartë, finalizon raportin e vlerësimit të jashtëm si më poshtë.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Teknik laborator”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Kolegji Universitar “REALD”, është një institucion jopublik i arsimit të lartë, i licencuar me VKM dt.14.09.2011 Nr. 650, hapur me emërtimin Akademia e Studimeve të Aplikuara “Reald”, riorganizuar me emrin Kolegji Universitar “REALD” (KUR) me vendim të UMAS Nr. 147, datë 31.03.2017. Institucioni ofron programe studimi në përputhje me interesat kombëtare dhe ato të institucioneve politikëbërëse në fushën e shëndetësisë, ekonomisë dhe teknologjisë. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, pjesë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Programi i studimit i ofruar nga DSTM, është në linjë me synimet dhe misionin e institucionit ashtu sikundër paraqitet në statutin e institucionit KUR. Evidenca nr 2. Statuti i Kolegjit Universitar “REALD”; Evidenca nr 4. Rregullore e përgjithshme KUR; Evidenca nr 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore;
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i ciklit të dytë të studimeve, Master i Shkencave në “Teknik laborator” është në përputhje me profilin që ka KUR, nevojat që kanë qendrat spitalore, shëndetësore publike e private në vend, për të punësuar teknik laborator. Programi i studimit i ofruar nga FSHM është në linjë me synimet dhe misionin e institucionit ashtu sikundër paraqitet në statutin e institucionit. Ky mision orientohet drejt krijimit, zhvillimit, e transmetimit të dijeve në aftësi dhe kompetenca të studentëve, të nevojshme këto, për t’u bërë profesionistë të denjë në praktikën laboratorike. Bazuar në informacionin e dhënë, programi synon edukim të studentëve, duke ruajtur dhe konsoliduar vlerat akademike e kulturore kombëtare në të njëjtën linjë me interesat kombëtare. Evidenca nr 2. Statuti i Kolegjit Universitar “REALD”;



	<p>Evidenca nr 4. Rregullore e përgjithshme KUR; Evidenca nr 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore; Takimi me drejtuesit e FSHM;</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p>	<p>GVJ evidenton se programi i studimit Msc në “Teknik laborator” është hartuar në përputhje me Statutin dhe Rregulloren themelore të KUR, dhe në zbatim të misionit dhe qëllimit të institucionit. Përmbajtja e tij, është hartuar, përditësuar dhe përshtatur nevojave që ka vendi por njëkohësisht ka reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën e ofrimit të shërbimeve laboratorike. Misioni dhe qëllimi i programit të studimit është përgatitja e specialistëve të aftë të fushës e shërbimeve laboratorike.</p> <p>Programi Msc në “teknik laborator” është vazhdim i programit bachelor në “Teknik laborator në mjeksi” që ka në focus organizimin dhe menaxhimin shëndetësor, në institucionet publike dhe private. Referuar dokumentacionit mbështetës, rezulton se programi ka objektiva të qarta që synojnë jo vetëm edukimin e teknikëve të laboratorit, për të shërbyer sa më mirë rrjetit shëndetësor vendas dhe jashtë tij, por edhe edukimin e tyre nga ana teorike, praktike dhe kerkimore-shkencore.</p> <p>Evidenca nr 2. Statuti i Kolegjit Universitar “REALD”; Evidenca nr 4. Rregullore e përgjithshme KUR; Evidenca nr 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore;</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar, Strategjinë e zhvillimit institucional të KUR, Strategjinë kombëtare të punësimit dhe arsim, Strategjia kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe informacionin si dhe objektivat dhe fushën e veprimtarisë së FSHM.</p> <p>Evidenca nr 2. Statuti i Kolegjit Universitar “REALD”; Evidenca nr 3. Strategjia e zhvillimit institucional 2021-2026;</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti i Shkencave Mjekësore ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, të përshkruara në Statutin dhe Rregulloren e institucionit, si dhe synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit të KUR, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij. Në të njëjtën linjë, edhe programi MSc. “Teknik laborator” i zhvillohet</i></p>

	<i>në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe interesit kombëtar të zhvillimit të mjekësisë</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2																				
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.																				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																			
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Programi i studimit MSc. në “Teknik laborator” është hartuar në përputhje me nevojat që ka vendi dhe tregu i punës duke përgatitur specialistë laborant. Sipas deklarimeve të drejtuesve, programet e studimit të ofruara nga KUR bazohen në studime të kryera nga institucioni lidhur me nevojat që ka rajoni dhe vendi. Referuar të dhënave në dispozicion, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, si njësi përgjegjëse që ofron programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka në përbërjen e tij, 41 personel akademik efektiv (PAE) i ndarë në katër njësi bazë, si:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Njësia bazë</th> <th>PAE</th> <th>Tituj/Grada</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike</td> <td>13</td> <td>5 - Dr. 8 - Msc</td> </tr> <tr> <td>Departamenti i Stomatologjisë</td> <td>13</td> <td>4 - Dr. 9 - Msc</td> </tr> <tr> <td>Departamenti i Farmacisë</td> <td>7</td> <td>1 - Prof. Dr. 3 - Dr. 3 - Msc</td> </tr> <tr> <td>Departamenti i Veterinarisë</td> <td>7</td> <td>2 - Prof. Dr. 3 - Dr. 2 - Msc</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>40</td> <td>40</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga sa më sipër, GVJ gjykon se fakulteti ka kapacitetet e nevojshme dhe stafin e kualifikuar për të ofruar me cilësi programin e studimit Msc “Teknik laborator”. <i>Edhe pse GVJ gjykon se fusha e formimit profesional të personelit akademik në disa raste nuk përputhet</i></p>		Njësia bazë	PAE	Tituj/Grada	Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike	13	5 - Dr. 8 - Msc	Departamenti i Stomatologjisë	13	4 - Dr. 9 - Msc	Departamenti i Farmacisë	7	1 - Prof. Dr. 3 - Dr. 3 - Msc	Departamenti i Veterinarisë	7	2 - Prof. Dr. 3 - Dr. 2 - Msc	Total	40	40
Njësia bazë	PAE	Tituj/Grada																		
Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike	13	5 - Dr. 8 - Msc																		
Departamenti i Stomatologjisë	13	4 - Dr. 9 - Msc																		
Departamenti i Farmacisë	7	1 - Prof. Dr. 3 - Dr. 3 - Msc																		
Departamenti i Veterinarisë	7	2 - Prof. Dr. 3 - Dr. 2 - Msc																		
Total	40	40																		

	<p><i>me lëndët që ata realizojnë në këtë program studimi.</i> Fakulteti ka burimet e duhura logjistike për të ofruar një mësimdhënie sa më cilësore, përmes laboratorëve dhe praktikave në spitale.</p> <p>Evidenca nr 12. Studimi për nevojat e tregut të punës për për specialistë “teknik laborator”;</p> <p>Evidenca nr. 40. Struktura akademike e FSHM 2023-2024;</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>KUR ofron programe studimi në fushën e ekonomisë dhe mjekësisë. Bazuar në Statutin e KUR, Rregulloren themelore e KUR, Rregulloren e FSHM, planin strategjik 2021-2026, fusha e përgjithshme dhe specifike e programeve të studimit është në përputhje me fushën kryesore të KUR. Programi i studimit MSc. “Teknik laborator”, është në të njëjtin profil që ka njësia kryesore fakulteti dhe institucioni. Programet e studimit në KUR, synojnë transmetimin e njohurive në shërbim të vendit dhe shoqërisë. Programet synojnë edukimin dhe kualifikimin shkencor e profesional të studentëve në fushën e ekonomisë dhe mjekësisë. Programi i studimit MSc. Teknik laborator, përgatit studentët me njohuritë e avancuara në fushën e shërbimeve laboratorike. Programi është organizuar dhe ofrohet në përputhje me udhëzimet dhe aktet nënligjore në fuqi. Programi i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe ka kodin e vet të përcaktuar nga ana e institucionit.</p> <p>Evidenca nr 2. Statuti KUR;</p> <p>Evidenca nr 5. Rregullorja e përgjithshme KUR;</p> <p>Evidenca nr 3. Strategjia e zhvillimit institucional 2021-2026;</p> <p>Evidenca nr 7. Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekësore;</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Edhe fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Fusha e përgjithshme është ajo e kujdesit shëndetësor, e cila është fusha kryesore e institucionit, ndërsa fusha specifike lidhet me teknik laborator. GVJ konstaton se referuar procedurës së ndjekur nga ana e institucionit për klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane, ato janë në përputhje me aktet e miratuara dhe ISCED.</p> <p>Evidenca nr 2. Statuti KUR;</p> <p>Evidenca nr 6. Rregullore e programit Msc teknik laborator;</p> <p>Evidenca nr 46. Silabuset Msc teknik laborator;</p>

	Evidenca nr 39. Tabela e kodifikimit të programeve të studimit;			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	N/A			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	KUR ofron programe studimi të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të diplomuarit në këtë institucion. KUR ka krijuar traditë në trainimin e vazhdueshëm për personelin apo studentët e diplomuar. Trajnimi i vazhduar në KUR në fushën e shërbimeve shëndetësore, ndihmohet edhe nga marrëveshjet që ky institucion ka me institucionet e kujdesit shëndetësor. Evidenca nr. 91. Raport vjetor I kërkimit shkencor; Evidenca nr. 25. Lista e IAL që KUR ka marrëveshje bashkëpunimi; Evidenca nr. 29. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit për praktikën profesionale;			
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se fakulteti ka kapacitetet e nevojshme dhe stafin e kualifikuar për të ofruar me cilësi programin e studimit MSc. Teknik laborator. Programi i studimit Master shkencor “Teknik laborator”, përgatit studentët me njohuritë e nevojshme si dhe aftësitë profesionale në fushën e shërbimeve laboratorike. GVJ konstaton se procedura e klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit është kryer sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane, ato janë në përputhje me aktet e miratuara dhe ISCED</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të	Marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda KUR dhe ndarja e detyrave dhe përgjegjësiive mes njësisë kryesore, njësisë baze dhe gjithë strukturave mbështetëse të programit janë të sanksionuar në një sere aktesh rregullative dhe mbikëqyrëse, si statuti rregullor e KUR,

<p>frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>rregullore e programit të studimit, dhe në udhëzime që përcaktojnë procedurat në funksion të këtij qëllimi.</p> <p>Programi i studimit Msc në “Teknik laborator” ofrohet nën përgjegjësinë e Departamentit të Shkencave teknike dhe mjeksore, pjesë e Fakultetit të Shkencave Mjeksore, që mbikqyr mbarëvajtjen e veprimtarisë mësimore në këtë program, si dhe kordinimin duke bashkëpunuar me drejtuesit e njësive bazë, në përputhje me rregulloren dhe statutin e KUR.</p> <p>Evidenca nr 2. Statuti Kolegjit Universitar “REALD”;</p> <p>Evidenca nr. 7. Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjeksore;</p> <p>Evidenca nr. 5. Rregullorja e përgjithshme e IAL;</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ konstaton se KUR ka një rrjet bashkëpunorësh të gjërë brenda dhe jashtë vendit. Rendësi në zhvillimin e programit ka marrëveshja e bashkëpunimit me spitalin rajonal Vlorë, si dhe klinika private. Këto marrëveshje krijojnë mundësinë e praktikave profesionale dhe mësimore, si dhe mundësinë e punësimit. GVJ konstaton se është e pranishme lista e marrëveshjeve me institucionet shëndetësore si dhe disa marrëveshje ne funksion te programit te studimit.</p> <p>Evidenca nr 25. Lista e IAL me të cilat KUR ka marrëveshje bashkëpunimi;</p> <p>Evidenca nr 29. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit për praktikën profesionale;</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në takimin me drejtuesit dhe personelin akademik, u evidentua se FSHM ka avantazh të madh në mundësitë që u ofrohen studentëve në zhvillimin e praktikave profesionale si pasojë e bashkëpunimit të ngushtë me institucione spitalore dhe klinika. Tregu rajonal, por edhe ai kombëtar ka nevojë për specialist të tillë.</p> <p>Evidenca nr 29. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit për praktikën profesionale;</p>



Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>Departamenti si njësi përgjegjëse e këtij program studimi evidenton nëpërmjet raporteve periodike të analizës vjetore përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit që ka institucioni me të tretet që reflektohen në analizën vjetore të departamentit.</p> <p>Evidenca nr. 77. Raporti I departamentit për vlerësimin e programit të studimit msc në teknik laborator;</p>		
Konkluzione	<p><i>FSHM ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione arsimore dhe spitalore vendase dhe të huaja, në kuadër të aftësisit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve. GVJ e konsideron si pikë të fortë nivelin e bashkëpunimit institucional dhe të programit me institucionet spitalore, veçanërisht në zhvillimin e praktikave profesionale dhe hulumtimeve shkencore që kryejnë studentët gjatë zhvillimit të temave të diplomave.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknik laborator” është hapur me urdhër të MAS Nr. 502, datë 06.09.2022. Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjeksore dhe i referohet nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), është i organizuar me 120 kredite (ECTS), kohëzgjatje 2 vite akademik (4 semestra), në gjuhën shqipe dhe kohë të plotë studimi, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e arsimit të lartë 80/2015. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në “Teknik laborator”. Programi i studimit përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar</p>

	<p>në VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p>Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë bazë 12 ECTS (10%); - Lëndë karakterizuese 60 ECTS (50%); - Lëndë ndërdisiplinore/ integruese 24 ECTS (20%); - Lëndë plotësuese 12 ECTS (10%); - Detyrime përmbyllëse dhe diploma 12 ECTS (10%); <p>GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve të programit të studimit në veprimtari formuese sipas kategorive nga A - E në ECTS/ përqindje përputhet me ato të parashikuar në VKM nr 41/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë.</p> <p>Evidenca nr. 43. Program mësimor Msc. Teknik laborator</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit është organizuar në përputhje me VKM 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknik laborator”, përmban një informacion të plotë në fushën e shërbimit laboratorik. Njohuritë e fituara në këtë program studimi, i krijon mundësi studentit që pas diplomimit të përshtatet me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucioni. Në kurrikulën e tij përfshihen lëndë që ofrojnë njohuri që nga menaxhimi shëndetësor, metodat e kërkimit shkencor, akreditimi laboratorëve, si dhe specifikat laboratorike për çdo organ të trupit. Njohuritë e fituara i shërbejnë studentit për përfundimin e aftësive dhe kompetencave për të kryer në mënyrë të pavarur menaxhimin e laboratorëve. Gjithashtu njohuritë e fituar në këtë program studimi shërbejnë si bazë për vazhdimin e studimeve të mëtejshme të doktoratës apo trajnimeve të tjera.</p> <p>Evidenca nr. 43. Program mësimor Msc. Teknik laborator</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknik laborator” është i organizuar me kohë të plotë në dy vite akademik të ndarë në katër semestra në total 120 ECTS nga të cilat 12 ECTS i përket praktikës profesionale, 18 ECTS detyrimeve përmbyllëse si punimit të diplomës. Praktika profesionale realizohet në institucionet shëndetësore me të cilat institucioni ka marrëveshje</p>

	<p>bashkëpunimi dhe mbikëqyret nga një pedagog dhe një staf nga institucioni ku kryhet praktika. Programi ka një rregullore të shkruar, ku flitet edhe për organizmin e praktikës profesionale, vlerësimin e studentëve për praktikën dhe librin e praktikës profesionale.</p> <p>Evidenca nr. 6. Rregullore e programit;</p> <p>Evidenca nr. 29. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit për praktikën profesionale;</p> <p>Evidenca nr. 20. Libri I praktikës profesionale;</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Nuk i përket këtij programi.</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Nuk i përket këtij programi.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të</p>	<p>Programi i studimit Msc në “Teknik laborator” organizohet dhe financohet bazuar në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikë ne Shqipërisë” dhe aktet nënligjorë të këtij ligji. Kriteret për pranimin e studentëve në programin e studimit si dhe kuotat e</p>

<p>veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>pranimi miratohet me vendim të senatit akademik të universitetit. Ky nuk është një institucion me status të veçantë.</p> <p>Evidenca nr. 6. Rregullore e programit;</p> <p>Evidenca nr. 33. Vendimi Senatit Akademik për miratimin e kritereve të pranimit për programin Msc;</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit Msc në “Teknik laborator” organizohet dhe financohet bazuar në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjorë të këtij ligji. Në intervistë me drejtuesit e institucionit referojnë që në dizajnimin e tij kanë marrë për referencë programe të ofruara nga universitete ndërkombëtare si dhe nga IAL të tjerë në vend.</p> <p>Evidenca : Takimi me drejtuesit e institucionit KUR</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Referuar RVB programi i studimit Msc në “Teknik laborator”, i ofruar nga EBU ka kodin përkatës (72MS) dhe përmban 120 Kredite ECTS për dy vite (4 semestra) studimi. Kodi 09 sepse programi i studimit ka lidhje me shëndet dhe mirëqënie. Kodi 14 tregon teknologji diagnostikimi dhe trajtimi mjeksor, ndërsa në kolonën 4 është shkronja S si identifikim i gjuhës shqipe.</p> <p>Kodi i plotë i programit të studimit Master i Shkencave në “Teknik laborator” është 72MS0914S, bazuar në VKM nr. 310 datë 11.5.2023 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në republikën e Shqipërisë”. Bazuar në këtë, kryhet edhe kodifikimi i lëndëve të programit: psh TLB 112: Epidemiologji dhe mjeksi preventive.</p> <p>Evidenca nr. 39. Tabela e kodifikimit të programeve të studimit;</p> <p>Evidenca nr. 43. Program mësimor Mec. Teknik laborator.</p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit programi Master i Shkencave në “Teknik laborator” nuk është program i përbashkët midis IAL-ve, jashtë apo brenda vendit por realizohet vetë nga KUR.</p> <p>Evidenca nr. 6. Rregullore e programit.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjeksore dhe i referohet nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) me kohëzgjatje 2 vite akademik, të ndarë në katër semestra në total 120 ECTS nga të cilat 12 ECTS i përkasin praktikës</i></p>

	<p>profesionale, 18 ECTS detyrimeve përmbyllëse si punimit të diplomës, dhe kod 72MS0914S, bazuar në VKM nr. 310 datë 11.5.2023 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në republikën e Shqipërisë" Programi zhvillohet në gjuhën shqipe dhe kohë të plotë studimi.</p> <p>Në përfundim të studimeve lëshohet diplome "Master i Shkencave" në "Teknik laborator". Programi i studimit Master i Shkencave në "Teknik laborator" përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2								
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.								
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve							
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Programi Msc në "Teknik laborator" zhvillohet në Departamentin e Shkencave Tekniko Mjeksore, Fakulteti i Shkencave Mjeksore (FSHM). FSHM është organizuar bazuar në ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë në republikën e Shqipërisë". Autoritet drejtuese janë Dekani, Zv. Dekani dhe Drejtuesit e Njesisë Bazë. Në përberje të tij janë 3 njësi bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Shkencave Tekniko mjeksore; • Departamenti i Stomatologjisë; • Departamenti i Farmacisë; • Departamenti i Veterinarisë. <p>Në vitin akademik 2023-2024 Fakulteti i Shkencave Mjeksore përfshin në strukturën e tij 63 anëtarë si personel akademik nga të cilët 41 anëtarë janë personel akademik efektiv (PAE) dhe 22 anëtarë janë personel akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin e mëposhtëm:</p> <table border="1" data-bbox="587 1697 1426 1814"> <tr> <td rowspan="2">Kualifikimi i stafit</td> <td colspan="2">Fakulteti i Shkencave Mjeksore</td> </tr> <tr> <td>PAE</td> <td>PAK</td> </tr> </table>			Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Mjeksore		PAE	PAK
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Mjeksore							
	PAE	PAK						

Prof.Dr	3	-
Prof.Asoc	-	3
Dr/PhD	13	14
Msc	25	5
Gjithsej	41	22

Bazuar në dokumentacionin e aplikimit nga institucioni shikojmë se Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore si njësi baze përgjegjëse e programit, ka arritur të plotësojë kërkesat ligjore dhe nënligjore lidhur me strukturën akademike dhe stafin akademik që është angazhuar në programin mësimor Msc “Teknik laborator” si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-
Prof. Asoc.	-	2	-	3
Dr./PhD.	5	1	3	5
Msc.	10	3	9	2
Totali	15	6	14	10

Evidenca nr 48. Stafin akademik i angazhuar në programin e studimit Msc teknik laborator;

Evidenca nr 40. Struktura akademike e FSHM 2023-2024.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore ka angazhuar në programin e studimit personel akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, grada shkencore apo Msc. si dhe staf ndihmës akademik/laborant.

Evidenca nr 40. Struktura akademike e FSHM 2023-2024.

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për

Bazuar në rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë, programi i studimit ka të emëruar koordinatorin e programit të

<p>programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>emëruar me vendim të drejtuesit të njësisë kryesore i cili është staf me kohë të plotë i KUR. Koordinatori i programit të studimit mbështet planifikimin, bashkë rendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e programit të studimit që mbulon, për të siguruar përmbushjen e misionit dhe objektivave të programit.</p> <p>Evidenca nr. 32. Vendim për emërimin e kordinatorit të programit mësimor dhe praktikës profesionale;</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi Msc në “Teknik laborator” zhvillohet në Departamentin e Shkencave Teknike Mjeksore në FSHM. Fakulteti është organizuar bazuar në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në përberje të tij janë 4 njësi bazë. Departamenti i Shkencave Teknike Mjeksore ku zhvillohet ky program studimi ka angazhuar në programet e studimit staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo MSH dhe staf ndihmës akademik. Bazuar në rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë, programi i studimit ka koordinorin e programit të emëruar me vendim të drejtuesit të njësisë kryesore. GVJ, shprehet se njësia kryesore dhe ajo baze përgjegjëse për programin e studimit përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>	

<p>Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit e vënë në dispozicion konstaton se Departamenti i Shkencave Teknike Mjeksore disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi nga pedagogu i çdo lënde si dhe sekretaria mësimore. Dokumentacioni i programit të studimit përfshin: informacion për institucionin, informacion për stafin akademik, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit. Nga takimi me stafin akademik u konstatua kjo gjë.</p> <p>Evidencë nr 6. Rregullorja e programit Msc teknik laborator;</p>

	<p>Evidencë nr 42. Staf i akademik i angazhuar në programin e studimit Msc teknik laboratorit;</p> <p>Evidencë nr 43. Programi mësimor Msc. Teknik laboratorit.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se struktura e programit të studimit Msc në “Teknik laboratorit”, përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e tij të përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në 2 vite akademike të ndara në 4 semestra, me 20 orë mësimi në javë. Numri i ECTS është 60 ECTS për çdo vit akademik, në total 120 ECTS ose 3000 orë mësimore prej të cilave 1440 janë orë në auditor dhe 1560 orë jashtë auditorit. Plani mësimor përshin lëndet/ disiplinat, praktikën dhe mbrojtjen e tezës si dhe veprimtari jashtë kurikulare. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, laboratorëve, praktikës. Frekuentimi i orëve teorike dhe praktike është i detyrueshëm në masën 75%. Një orë mësimore është 50 minuta. Të gjithë këto elementë gjenden në planin mësimor të ofruar nga departamenti.</p> <p>Evidencë nr 6. Rregullorja e programit Msc teknik laboratorit;</p> <p>Evidencë nr 7. Rregullore e FSHM;</p> <p>Evidencë nr 43. Programi mësimor Msc. Teknik laboratorit.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstaton se institucioni ka informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit. Studentet nëpërmjet planit mësimor dhe kuadrit rregullator të brendshëm, rregulloret e studimit në rang institucional, njësi kryesore/baze, dhe nivel programi kanë informacionin e duhur që në procesin e pranimit, regjistrimit dhe zhvillimit të programit ashtu edhe procedurat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Në takimin me studentët rezultoi që studentët kishin informacion dhe institucioni aplikon kriteret specifike përzgjedhëse në pranime të vendosur me VKM.</p> <p>Evidencë nr 6. Rregullorja e programit Msc teknik laboratorit;</p> <p>Evidenca nr 7. Rregullorja e FSHM; Takimi me studentët;</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban</p>	<p>Programi i studimit përmban informacionin lidhur me sylabuset që zhvillon në programin Msc në “Teknik Laboratorit”. Sylabuset e</p>

informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.

lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi tematikën e lëndës, ndarjen në leksione, seminare, praktikë mësimore/profesionle, ECTS përkatëse, literaturën përkatëse, pedagogun që zhvillon lëndën, formën, kohën e vlerësimit dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të dijeve të studentit dhe literaturën përkatëse të detyruar dhe të rekomanduar. Programi ka rregullore për praktikën profesionale ku përfshihen tematika dhe udhëzime lidhur me realizimin e saj, numri i orëve të praktikës profesionale dhe ETC përkatëse praktika profesionale është 144 orë në vitin e dytë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton:

- sylabuset janë organizuar/ formatuar në përputhje me VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”;
- në disa sylabuse titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor sipas Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 59 “Kategoritë e personelit akademik”;
- *Fusha e formimit profesional të personelit akademik nuk përputhet me lëndët që ata realizojnë në këtë program studimi. Pedagog me formim Mjek Psikiatër zhvillon lëndën “Testet laboratorike në obstetrikë-gjinekologji”, staf akademik me formim Biologji zhvillon lëndën “Testet laboratorike në geriatrikë”, apo pedagog me formim në Shkencat e Natyrës zhvillon lëndë mjekësore si “Biokimi klinike e avancuar”.*
- *Literatura në sylabuse mungon ose është shumë e vjetëruar (vitet 2005--2010);*
- *Disa sylabuse kanë nevojë për rishikim duke qenë se sylabusi i imunologji ka tema mikrobiologjike që nuk përputhen me lëndën, sylabusi i “Mjeksisë transfusive” trajton tema hematologjike që trajtohen në lëndën e “Hematologjisë”, si dhe mendojmë se duhen futur konceptet e menaxhimit të laboratorit në lëndën “Organizimim, Menaxhim dhe Promocion Shëndeti”, duek qenë se i përshtaten më shumë profilit të programit të studimit.*

GVJ rekomandon institucionin që të rishikojë sylabuset duke mbajtur në konsideratë komentet me sipër, me qëllim përmirsimin e programit të studimit.



	<p>Evidenca nr 43. Programi mësimor Msc teknik laboratorit;</p> <p>Evidenca nr 46. Syllabus Msc teknik laboratorit;</p> <p>Evidenca nr 6. Rregullore e programit Msc teknik laboratorit; Rregullorja e programit të studimit të ciklit të dytë;</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Departamenti ku zhvillohet programi i studimit ka përshkruar procedurën për përmirësimin dhe përditësimin e përmbajtjes së programit të studimit. Në fillim të cdo vitit akademik bëhet rishikimi i sylabuseve dhe literaturës për cdo lëndë. Në këtë proces përfshihen dhe studentët të japin mendimin e tyre, si dhe mekanizma të përmirësimit të cilësisë në kuadër të NJSBC. Lëndët që kanë leksione të shkruara rishikohen cdo vit dhe leksionet arkivohen së bashku me sylabuset në formë hard copy dhe elektronike në departament dhe drejtorinë e standarteve dhe kurikulave.</p> <p>Evidenca nr 7. Rregullore e FSHM;</p> <p>Evidenca 43. Program mësimor Msc teknik laboratorit;</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Dokumentacioni i programit të studimit "Teknik laboratorit" përfshin: informacion për institucionin, informacion për stafin akademik, sylabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit.</i></p> <p><i>-Struktura e programit të studimit Msc në "Teknik laboratorit", përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e tij të përcaktuar në VKM nr.41/2018.</i></p> <p><i>-Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në 2 vite akademike të ndara në 4 semestra. Numri i ECTS është 60 ECTS për çdo vit akademik, në total 120 ETC ose 3000 orë mësimore prej të cilave 1440 janë orë në auditor dhe 1560 orë jashtë auditorit. Plani mësimor përshin lëndet/ disiplinat, praktikën dhe mbrojtjen e tezës si dhe veprimtari jashtë kurikulare</i></p> <p><i>-Programi i studimit përmban informacionin lidhur me sylabuset që zhvillon në programin MSH në teknk laboratorit. Në disa sylabuse titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor, lektorët janë të gjithë të kategorisë Doktorë i shkencash.</i></p> <p><i>-Institucioni ka informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fusha të veçanta dhe të specializuara të teknik laboratorit të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. Shpërndarja e lëndëve sipas kategorive A, B, C, D, E që mundëson dhënien e njohurive të thelluara. Në programin e studimit i jepet rëndësi e veçantë formimit praktik profesional të studentit, ku orët e praktikës mësimore përbëjnë 10% të totalit të krediteve.</p> <p>Evidenca nr 6. Rregullorja e programit Msc teknik laboratorit; Evidenca nr 43. Program mësimor Msc teknik laboratorit.</p>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	<p>Organizimi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/ ECTS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit “Teknik laboratorit”, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale. Me njohuritë e marra në këtë program, studentët e ndjejnë veten të aftë në vendet e tyre të punës dhe dijet e marra janë në funksion të plotë të veprimtarisë së përditshme të tyre. Lëndët dhe praktika në program si dhe ngarkesa e tyre në kredite/ orë mësimore përputhet me profilin e programit të studimit.</p> <p><i>Në vitin e parë</i> zhvillohen më shumë lëndë të formimit karakterizues dhe lëndë ndërdisiplinore (42.5 ECTS nga 60 ECTS). <i>Në vitin e dytë</i> zhvillohen më shumë lëndë të formimit karakterizues (25 ECTS nga 60 ECTS). Numrin më të madh të krediteve e kanë lëndët e formimit profesional. Studentët kanë mundësi të aftësohen me shprehitë profesionale praktike gjatë zhvillimit të praktikave mësimore në spitalin rajonal Vlorë apo klinikat me të cilat KUR ka marrëveshje.</p> <p>Evidenca nr 43. Program mësimor Msc teknik laboratorit;</p>

	Evidenca nr 29. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private për praktikën profesionale të studentëve.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Gjatë takimit me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se programi është bazuar në programe të ngjashme në Shqipëri afërsisht 80% i njëjtë, si dhe kanë marrë modele të ngjashme ndërkombëtare psh në Universitetin “Aldo Moro” të Barit pothuajse 100% i njëjtë. Raporti teori praktikë është në funksion të formimit profesional në përputhje me profilin e programit të studimit MSc në “Teknik laborator”. Programi ka më shumë orë të punës individuale 1560 orë dhe punë në klasë 1440 orë. Takimit me stafin drejtues të FSHM dhe stafin akademik; Evidenca nr 43. Program mësimor Msc teknik laborator.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja në kategori sipas veprimtarive formuese dhe raportet e ngarkesës së tyre bazuar në legjislacionin në fuqi, ndikojnë në arritjen e objektivave të programit dhe transferimin, mobilitetin e studentëve në programe të tjera studimi të ngjashme. Njohuritë e marra në këtë program dhe kurrikula e tij, ju krijon mundësi punësimi studentëve në sektorin publik dhe privat brënda dhe jashtë vëndit. Evidenca nr 43. Program mësimor Msc teknik laborator
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	FSHM dhe njësitë bazë kanë një praktikë të mirë dokumentuar lidhur me rishikimin në mënyrë të vazhdueshme të programit apo sylabuseve të lëndëve duke u bazuar në literaturë ndihmëse dhe të detyruar. Programi i studimit ju siguron studentëve literaturën bazë që janë tekse mësimorë të pedagogëve të KUR apo literaturë ndërkombëtare. Tekset mësimore për pjesën teorike, seminare, laboratore, ushtrime propozohen nga titullarët e lëndëve dhe miratohen nga departamenti. Ky informacion gjëndet në fund të çdo syllabusi. <i>Megjithatë, GVJ rekomandon rishikimin e disa sylabuseve që u përmenden më sipër, duke qenë se në disa raste hasen probleme në literaturën dhe përmbajtjen e tyre.</i> Evidenca nr 46. Syllabus Msc teknik laborator.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve,	Përmbajtja e programit të studimit i shërben rritjes së kapaciteteve profesionale në fushën e teknikës laboratorike, aftësimin profesional teorik dhe praktik. Në takimin me drejtues të

aftësive dhe kompetencave të synuara.	<p>institucionit dhe të departamentit u referua se FSHM po punon për përditësimin e kurikulës, e cila do të mund të bëhet vetëm pas marrjes së akreditimit të parë.</p> <p>Evidenca nr 6. Rregullorja e programit Msc teknik laborator; Evidenca nr 43. Program mësimor Msc teknik laborator;</p>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Përmbajtja e programit i shërben studentëve për fitimin e njohurive në teknikën laboratorike dhe thellimin e njohurive të përfuara në këtë program studimit në kualifikime të mëtejshme apo ndjekje të doktoraturës. Lëndët/ modulet që studenti zhvillon në këtë program studimi përbëjnë bazën për përfitimin e kompetencës profesionale për punësimin e tyre dhe përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Evidenca nr 6. Rregullorja e programit Msc teknik laborator; Evidenca nr 43. Program mësimor Msc teknik laborator;</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vëren se programi u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fushën e teknikës laboratorike të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit i jep rëndësi të veçantë formimit praktik profesional të studentit. Numrin më të madh të krediteve e kanë lëndët e formimit profesional. Programi i studimit ju siguron studentëve literaturën bazë që janë tekste mësimorë të pedagogëve apo ajo ndërkombëtare. Lëndët/ modulet që studenti zhvillon në këtë program studimi përbëjnë bazën për përfitimin e kompetencës profesionale, për punësimin e tyre dhe përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të	FSHM cdo fillim viti akademik bën përditësimin e programit të studimit dhe për përshtatjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. Në këtë proces një vënd të rëndësishëm zënë dhe informacionet e marra gjatë takimeve me përfaqësues aktorë dhe faktorë të ndryshëm në fushën e kujdesit shëndetësor më të cilët kanë marrëveshje bashkëpunimi. Institucioni gjithashtu merr

<p>studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>parasysh edhe propozimet e studentëve përmes një procedure të konsoliduar.</p> <p>Evidenca nr 12. Studimi tregu Msc teknik laboratorit;</p> <p>Evidenca nr 74. Pyetsor për studentët;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Pjesë e rishikimit apo përditësimit të programit mësimor janë dhe propozimet e bëra nga studentët e programit të cilët janë në proces. Kjo është një praktikë e konsoliduar e KUR në lidhje me programet e tjera tradicionale. Mbështetja e studentëve dhe përfshirja e tyre në përmirësimin e programeve realizohet me anë të përfshirjes së studentëve në Senatin akademik, NJSBC. Duke qënë pjesë e vendimarrjes ata ndikojnë dhe në përmirësim të programit të studimit.</p> <p>Institucioni përdor mekanizma të ndryshme për marrjen e mendimit të studentëve për programin mësimor si plotësimi i përvitshëm pyetësorëve. KUR ka edhe strukturën Zyra e këshillimit të karrierës, që ofron këshillim për periudhën pas diplomimit të të studentëve në KUR.</p> <p>Evidenca nr 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD;</p> <p>Evidenca nr 7. Rregullore e FSHM.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Cdo vit akademik njësia bazë ku zhvillohet ky program studimi bën rishikim, përditësim të kurikulave. Një vend të rëndësishëm në këtë proces zënë instrumentat e vlerësimit të cilësisë për studentët si edhe institucioneve shëndetësore ku janë të punësuar të diplomuarit, me të cilat bashkëpunon KUR.</p> <p>Programi i studimit MSc në teknik laboratorit është i ri, por mekanizmat janë të përcaktuar në rregulloret e tij.</p> <p>Evidenca nr 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD;</p> <p>Evidenca nr 7. Rregullore e FSHM.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se Departamenti cdo fillim vitit akademik bën përditësim e programit të studimit dhe për përshtatjen e programit të studimit me kerkesat e tregut të punës. Institucioni përfshin në procesin e rishikimit të kurikulave studentët me anë të mekanizmarve të ndryshme si plotësimi i përvitshëm pyetësorëve, përfshirjen e përfaqësuesve të tyre në senatin akademik, NJSBC. Një anë positive është përfshirja në këto konsultime edhe e studentëve të punësuar në struktura shëndetësore si dhe punëdhënësit të tyre. Institucioni</i></p>



	<i>ka Zyrën e këshillimit të karrierës që ofron këshillim për periudhën pas diplomimit të të studentëve në KUR.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Programi i studimit Mastër i shkencave në “Tenik laborator” ka si objektiv kryesor formimin profesional dhe shkencor bashkëkohor të teknikëve të laboratorit të niveleve të ndryshme në sistemin shëndetësor. Gjithashtu, ngritja e kapaciteteve të teknikës laboratorike dhe menaxhimit laboratorik, në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke u mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të Kolegjit Universitar REALD 2021-2026, janë objektiva kryesorë të programit të studimit.</p> <p>Evidenca nr 3. Strategjia e zhvillimit institucional 2021-2026;</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	<p>Në Statutin e KUR theksohet që Njësia kryesore dhe njësia bazë ku zhvillohet ky program studimi organizon dhe administron aktivitetin e mësimdhënies, aktiviteteve dhe veprimtarive kërkimore shkencor duke respektuar opinionet, idetë dhe metodat në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik dhe krijues të procesit të mësimdhënies, aktivitetit kërkimor shkencor dhe veprimtarive të tjera akademike. Institucioni organizon dhe leksione të hapura me personalitete të cilët bashkëbisedojnë më pedagogët dhe studentët për problematika të vecanta lidhur me menaxhimin shëndetësor.</p> <p>KUR bashkëpunon me Spitalin Rajonal Vlorë dhe klinika laboratorike provate për kryerjen e praktikave dhe edukimin profesional.</p> <p>Evidenca nr 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD;</p> <p>Evidenca nr 80. Strategjia dhe plani i punës afatmesëm i kërkimit shkencor 2019-2024;</p> <p>Evidenca nr 7. Rregullorja e FSHM;</p> <p>Evidenca nr 29. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet publike dhe private për praktikën profesionale të studentëve.</p>

<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Program i studimit i motivon studentët të përfshihen në punë të mirëfilltë projektuese dhe kërkimore që kontribuojnë në formimin profesional dhe shkencor. Studentët janë angazhuar në organizimin dhe pjesmarrjen e tyre në ëorkshope, konferencave shkencore apo trainuese. Studentët janë pjesmarës në këto aktivitete me punimet e tyre.</p> <p>Evidenca nr 81. Programi i kongresit shkencor ndërkombëtar – Shkencat mjeksore dhe inovacioni;</p> <p>Evidenca nr 89. Dokumentacioni i projektit european Blu arrow;</p> <p>Evidenca nr 80. Strategjia dhe plani i punës afatmesëm i kërkimit shkencor 2019-2024;</p>			
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik u referua se institucioni KUR i mbështet financiarisht në realizimin e aktiviteteve kërkimore shkencore brenda dhe jashtë vendit. Institucioni ka alokuar 28,000 Euro për kërkimin shkencor për vitin kalendarik 2024. Veprimtaria kërkimore shkencore në KUR është e garantuar përmes Strategjisë përkatëse.</p> <p>Evidenca nr 80. Strategjia dhe plani i punës afatmesëm i kërkimit shkencor 2019-2024;</p> <p>Evidenca nr 90. Plan pune për kualifikimin e stafit akademik në fushën kërkimore shkencore;</p> <p>Evidenca nr 91. Raport vjetor i kërkimit shkencor.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se Njësia kryesore/ bazë ku zhvillohet ky program studimi organizon dhe administron aktivitetin mësimdhënies, aktivitetet dhe veprimtaritë kërkimore shkencore. Institucioni organizon dhe leksione të hapura me personalitete të cilët bashkëbisedojnë më pedagogët dhe studentët për problematika të vecanta lidhur me teknikat laboratorike. Institucioni mbështet financiarisht stafin akademik në aktivitetin kërkimor shkencor duke i përfshirë në projekte shkencore. Program i studimit i motivon studentët duke i përfshihen në punë të mirëfillta projektuese dhe kërkimore që kontribuojnë në formimin profesional dhe shkencor.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>KUR i kushton një rëndësi të veçantë harmonizimit të aktivitetit mësimor me atë kërkimor shkencor ku një vëmendje të veçantë i kushtohet përfshirjes së studentëve në kërkim shkencor. Departamenti i Shkencave Teknike Mjeksore është i organizuar në grupe mësimore dhe kërkimore, që kanë në përbërje personel me profilin e duhur akademik. Institucioni ka investuar për ndërtimin e ambienteve të paisur me teknologji të mirfilltë për realizimin e eksperimenteve të kërkimit shkencor sic janë laboratorët mësimore apo aplikimit dhe fitimin e projekteve të financuar nga institucione kombëtare apo ndërkombëtare, sic është projekti “Blue arrow” në kuadër të Erasmus +.</p> <p>Evidenca nr 89. Dokumentacioni i projektit european Blu arrow; Evidenca nr 91. Raport vjetor i kërkimit shkencor;</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Teknike Mjeksore si edhe njësiti bazë të tjera të KUR në cdo fillim viti hartojnë planin vjetor me fokus në procesin mësimor dhe kërkimin shkencor. Pjesë e zbatimit të këtyre planeve janë si personeli akademik ashtu edhe studentët e programeve të ndryshme, dhe në vecanti të programit të studimit Msc në Teknik laborator. Stafi akademik përgjegjës për këtë program studimi ka kapacitetet e duhura për t’iu përgjigjur kërkesave të ndryshme të tregut.</p> <p>Evidenca nr 80. Strategjia dhe plani i punës afatmesëm i kërkimit shkencor 2019-2024; Evidenca nr 90. Plan pune për kualifikimin e stafit akademik në fushën kërkimore shkencore; Evidenca nr 91. Raport vjetor i kërkimit shkencor.</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Referuar RVB dhe takimeve në institucion, konstatohet se Departamenti i Shkencave Teknike Mjeksore, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Msc në Teknik laborator, gjatë vitit 2023-2024 ka organizuar disa aktivitete shkencore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kongresi shkencor ndërkombëtar – Shkencat mjeksore dhe inovacioni Qershor 2024; 2. Seminar Internacional Universiteti Salernos dhe KUR 2023. <p>Këto konferenca ndihmojnë si personelin akademik ashtu edhe studentët për arritjen e objektivave mësimorë.</p> <p>Evidenca nr 81. Programi i kongresit shkencor ndërkombëtar – Shkencat mjeksore dhe inovacioni 2024;</p>

	Evidenca nr 84. 2. Seminar Internacional Universiteti Salernos dhe KUR 2023; Evidenca nr 91. Raport vjetor i kërkimit shkencor 2023-2024;
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi studimit MSc në Teknik laborator, bazuar në objektivat dhe misionin e tij synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e teknikës laboratorike, në nivele të ndryshme të tij, dhe element si: - Akreditimi i laboratorëve - Biokimi klinike e avancuar - Teknikat laboratorike, etj Evidenca nr 43. Programi mësimor Msc teknik laborator;
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Programi i studimit Msc në teknik laborator është i ri në KUR dhe ka marrë në konsideratë gjatë fazës së studimit të tregut edhe rekomandimet nga aktorë dhe faktorë në fushën e shëndetësisë, sidomos partnerëve të tij strategjikë rajonalë dhe kombëtar. Evidenca nr 12. Studim tregut Msc teknik laborator;
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Nuk aplikohet sepse nuk përfshihet në profesionet e rregulluara produkti i këtij programi.
Konkluzione	<i>GVJ vëren se KUR ka një harmonizimit të aktivitetit mësimor me atë kërkimor shkencor ku një vëmendje të rëndësishme zë përfshirja e studentëve në kërkim shkencor. IAL ka investuar për ndërtimin e ambienteve të paisur me teknologji të mirfilltë për detyra kursi sic janë laboratorët mësimore apo aplikimi dhe fitimin e projekteve të financuar nga institucione kombëtare apo ndërkombëtare, si projekti "Blu arrow". FSHM për realizmin e punëve kërkimore shkencore ka marrëveshje bashkëpunimi me strukturat spitalore rajonale dhe klinika laboratorike private. Programi studimit ka krijuar infrastrukturën e nevojshme për rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e teknikës laboratorike në çdo nivel, si dhe për tu</i>

	<i>përshtatur me tregun e punës si brenda vëndit ashtu edhe jashtë tij. Institucioni ka njësinë e kërkimit shkencor dhe projekteve e cila informon stafit për thirjet e projekteve me fonde nga burime jashtë institucionit</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	GVJ vëren se për realizimin e procesit mësimor personeli akademik i KUR përdor metoda të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika profesionale, detyra kursi, tema diplome si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti. Gjatë mësimdhënies përdoren metoda alternative si prezantime në Power Point, biseda interaktive me studentët apo temave të vecanta nga studentët dhe diskutimi i tyre. Staf i akademik asiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mësimin apo praktikës mësimore. Evidenca nr 46. Sylabus Msc teknik laborator; Takim me personelin akademik; Takim me studentët;
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Institucioni ka siguruar infrastrukturën mesimore të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre ne funksion të formimit të tyre profesional teorik. Institucioni ka krijuar infrastrukturë laboratorike të cilat ju shërbejnë studentëve për aftësimin e tyre praktik dhe profesinal. Takimime stafin akademik, Vizita në institucion;

<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>U konstatua se institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesmarje në program bashkëpunimi për shkëmbim eksperiencace midis IAL në kuadër të programeve Erasmus, konferenca shkencore, aktivitetet trainuese sipas shkallës së kualifikimit, përgatitje të projekteve, përfshirjen e tyre në marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo jo publike, vendase dhe të huaja.</p> <p>Takim me stafin akademik; Evidenë nr.91: Raporti i kërkimit shkencor viti akademik 2023-2024 (aktivitete-aplikim për projekte)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit MSc në Teknik laborator ka përgatitje profesionale pedagogjike në lëndët që zhvillon. <i>GVJ sic është shprehur dhe më sipër, fusha e formimit profesional të personelit akademik, në disa raste nuk përputhet me lëndët që ata realizojnë në këtë program studimi.</i></p> <p>Stafi akademik është me formim në universitetet brenda dhe jashtë vendit. Për ta bërë pjesën teorike të lëndëve sa më tërheqës për studentin institucioni mundëson stafin akademik përdorimin e metodave të ndryshme mësimdhënie si projektorët, prezantime power point, metoda interaktive. Sic është theksuar edhe në standartet e mësipërme, IAL ka investuar në krijimin infrastrukturën e nevojshme laboratorike për demonstrimin e praktikave mësimore.</p> <p>Takim me stafin akademik; Evidenca: CV e stafit angazhuar në programin MSc në Teknik laborator;</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësori, pyetësor për vlerësimin e performancës, si dhe përfaqësim të tyre në struktura drejtuese si senati akademik.</p> <p>Takim me studentët; Takim me zyrën e NJSBC; Evidenca nr. 74. Model pyetsori për studentët; Evidenca nr 76. Pyetsor për vlerësimin e performancës.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në</p>	<p>Institucioni ka të organizuar me akte rregullatore mënyrën e funksionimit të KUR/ Fakulteteve/ departamenteve të cilat janë në</p>



<p>nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>funksion të organizimit të mësimdhënies në programe të ndryshme që ka KUR. Njësitë kryesore që asistojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencorë janë NJSBC dhe Komisioni Përhershëm i përmirësimit të cilësisë. NJSBC është përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional. Në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, shërbejnë dhe leksionet e hapura të organizuar nga departamentet, pjesëmarrja e lektorëve të jashtëm, trajnimet periodike të stafit akademik. Stafi akademik përdor metoda të ndryshme mësimdhënie për ta bërë pjesën teorike të lëndëve sa më tërheqës për studentin si me anë të projektorëve, prezantime pour point, paraqitjen e materialeve audiovizive, metoda interaktive, organizmin e leksioneve të hapura me pedagogë dhe expert të jashtëm.</p> <p>Evidenca nr 2. Statuti Kolegjit Universitar Reald; Evidenca nr 4. Rregullorja e përgjithshme e KUR; Takim me zyrën e NJSBC; Takim me stafin akademik.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KUR dhe personeli akademik përdor metoda të ndryshme në mësimdhënie për realizimin e procesit mësimor dhe transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika profesionale, detyra kursi, tema diplome si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti. IAL ka siguruar infrastrukturën mësimore të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike të ndryshme në funksion të formimit profesional, teorik dhe praktik të studentëve.</i></p> <p><i>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale dhe eksperincë mjekësorë apo pedagogjike në lëndët që zhvillon. NJSBC është përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumnetacionit të vënë në dispozicion dhe takimet e zhvilluar në institucion me studentët dhe pedagogë</p>



<p>njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>konstatoi se vlerësimi i njohurive të studentëve dhe aftësive profesionale të stafit bazohen në rregulloret e institucionit miratuar nga Senati Akademik. Studentët njihen me këto rregullore gjatë tureve të orientimit të studentëve si dhe nga pedagogu i lëndës në fillim të sylabusit përkatës. Gjithë informacionin studentët e gjenë edhe në platformën e komunikimit elektronik.</p> <p>Evidenca nr 6. Rregullorja e programit Msc teknik laborator; Takim me studentët e programit të studimit;</p> <p>Evidenca nr 105. Platforma për komunikimin elektronik.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në sylabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të lëndës pedagogu prezanton sylabusin e lëndës, mënyrën e realizimit të procesit mësimor, tematikën e leksioneve, seminareve dhe praktikave laboratorike dhe orët mësimore përkatëse sipas ECTS që ka lënda. Pedagogu informon studentit për mënyrën e frekuentimit të procesit mësimor dhe vlerësimit të dijeve. Frekuentimi i procesit mësimor (leksione, seminare) është detyrueshëm në masën 60% pwr leksionet, 75% të orëve pwr seminarët, frekuentimi laboratorëve mësimore dhe praktikës profesionale në masën 100%. Vlerësimi i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme sipas rregullores së FSHM dhe rregullores së programit mësimor. Gjithë informacioni ju vihet në dispozicion studentëve nga pedagogu i lëndës dhe në cdo sylabus. Gjithë informacionin studentët e gjenë edhe në platformën e komunikimit elektronik.</p> <p>Evidenca nr 6. Rregullore e programit Msc teknik laborator; Takim me studentët e programit të studimit;</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale kryhet në mënyrë të vazhdueshme sipas tipologjisë së lëndëve dhe bazohet në rregulloren e programit të studimit Msc në Teknik laborator. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) me provim me shkrim; b) me gojë ose i kombinuar; c) me detyra kursi, projekte; <p>Provimet me shkrim bëhen të sekretuara. Për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi i vlerësimit me 10 nota, nga 4-tra tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Nota më e ulët për kalim në një lëndë është 5 (pesë).</p> <p>Evidenca nr 6. Rregullore e programit Msc teknik laborator; Takim me personelin akademik;</p>



Konkluzione	<i>Frekuentimi i procesit mësimor dhe vlerësimi i dijeve të studentit bazohet në rregulloren e programit të studimit. Studenti njihet me frekuentimit e programit mësimor dhe vlerësimin e dijeve nga pedagogu i lëndës në fillim të sylabusit përkatës si dhe përmes platformës së komunikimit elektronik. Në cdo sylabus paraqitet dhe mënyra e vlerësimit nga pedagogu dhe student i nënshtrohet vlerëmit të vazhduar.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në sylabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Bazuar në DVV, sylabuset e lëndëve, vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas formës së vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, pjesëmarrjes dhe diskutimeve në seminare dhe laboratorë, detyrave të kursit etj, sipas komponentëve të përcaktuar në sylabusin e lëndës, ku pesha e vlerësimit të vazhdueshëm është 40% dhe e vlerësimit përfundimtar 60%.</p> <p>Institucioni zotëron të gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe ju vihet këtyre të fundit në dispozicion nga pedagogu i lëndës dhe në cdo sylabus.</p> <p>Evidenca nr 6. Rregullore e programit Msc Teknik laborator;</p> <p>Evidenca nr 64 Sylabus Msc teknik laborator;</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive është realizuar kryesisht duke kombinuar metodat tradicionale me mjetet elektronike (hartimi, postimi dhe prezantimi i detyrave të kursit/projekteve).</p> <p>Provimi përfundimtar për lëndën bëhet nën mbikqyrje me kamera me qëllim që të shmangë abuzimin dhe rrisin transparencën.</p> <p>Evidenca nr 6. Rregullore e programit Msc teknik laborator;</p> <p>Takim me stafin akademik;</p>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në	<p>Vlerësimi i dijeve të studentit bëhet sipas rregullores së FSHM dhe rregullores së programit të Msc teknik laborator. Vlerësimi i dijeve bëhet në provim të ndërmjetëm, provim përfundimtarë,</p>

<p>përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>riprovimi dhe provim i përmirësimit. Teza e provimit hartohet nga pedagogu i lëndës dhe vlerësimi i dijeve bëhet me sistemin e notave ku 5 është nota minimale kaluese dhe 10 maksimale. I gjithë procesi i vlerësimit përfundimtar bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p> <p>Evidenca nr 6. Rregullore e programit Msc teknik laborator; Evidenca nr 46. Syllabus Msc teknik laborator;</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive bëhet sipas rregullave të përcaktuara në rregulloret institucionale. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen dijet dhe puna individuale e studentit. Bazuar në kuadrin rregullator të institucionit për provimet, pas çdo testimi studentët njihen me vlerësimin, bëjnë komente apo ankesë ndaj vlerësimit, si dhe marrin këshillat e duhura për procesin e të mësuarit të vazhdueshëm në të ardhmen dhe përmirësimin e tyre.</p> <p>Evidenca nr 6. Rregullore e programit Msc teknik laborator.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>GVJ vëren se institucioni ka investuar në sisteme për të siguruar integritetin, transparencën dhe cilësinë e provimeve. Për këtë, IAL ka pajisur ambjntet me kamera vëzhgimi, por edhe organizimi i provimit kryhet në mënyrë të tillë që student të mos ketë mundësi të kopjojë.</p> <p>Evidenca nr 6. Rregullore e programit Msc teknik laborator;</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Realizimi i provimit dhe komunikimi i rezultateve bëhet sipas rregullores së programit të MSc Teknik laborator. Rezultatet pasqyrohen në procesverbalin e vlerësimit dhe i bëhen të ditura studentëve brenda 3 ditëve. Një ditë pas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve dhe printohet proces verbal, firmoset nga lektori dhe dorëzohen në sekretarinë mësimore në 2 (dy) kopje, nga të cilat 1 (një) kopje qëndron në sekretarinë mësimore, 1 (një) kopje në departamentin përkatës.</p> <p>Evidenca nr 4. Rregullorja e përgjithshme e KUR; Evidenca nr 6. Rregullore e programit Msc teknik laborator;</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 24 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin. Me rregulloren e zhvillimit të provimit studentët njihen paraprakisht nga pedagogu i lëndës. Studentët shprehen të</p>




statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve. Evidenca nr 5 Rregullorja e përgjithshme e IAL; Evidenca nr 6. Rregullorja e programit Msc teknik laborator;		
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	GVJ vlerëson që një student i cili ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi, ai ka të drejtën e ankimimit, e cila vlerësohet nga një komision që ngrihet me vendim Dekani, brenda 24 orësh nga marrja dijeni për ankesën nga Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. Evidenca nr 5 Rregullorja e përgjithshme e IAL; Evidenca nr 6. Rregullorja e programit Msc teknik laborator;		
Konkluzione	<i>Vlerësimi i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik. Vlerësimi i dijeve bëhet në provim të ndërmjetëm, provim përfundimtarë, riprovimi dhe provim i përmirësimit. Rezultatet e provimit ju komunikohen studentëve në kohë duke respektuar afatet ligjore të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit. Studenti ka të drejtën e ankimimit të rezultatit. Procedura e ankimimit kryhet sipas rregullores së përgjithshme të KUR dhe të programit të studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit të ciklit të dytë Master i shkencave “Teknik laborator” është me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe ka 120 ECTS në total. Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor. 1 orë mësimore – 50 minuta. 1 ECTS = 25 orë punë studentit në auditor dhe ashtë auditorit. Procesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, apo praktika profesionale. Organizmi i programit mësimor si dhe kurikulat e programit/ syllabuset/ lëndët mësimorë mundësojnë

	<p>formimin profesional të thelluar dhe zhvillim të aftësive të vecanta si aftësi organizative, kërkim të pavarur shkencor, punën në grup.</p> <p>Evidenca nr 6. Rregullorja e programit Msc teknik laborator;</p> <p>Evidenca nr 43. Program mësimor Msc teknik laborator;</p> <p>Evidenca nr 46. Sylabus Msc teknik laborator;</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Pjesë të programit mësimor përveç lëndëve të formit profesional janë dhe ato të formit të përgjithshëm si: shkrim akademik dhe kërkim shkencor, bioetike dhe komunikim profesional, organizim, menaxhim dhe promovion shëndeti, duke i dhënë mundësinë studentit të zhvillojë aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p> <p>Evidenca nr 43. Program mësimor Msc teknik laborator;</p> <p>Evidenca nr 46. Sylabus Msc teknik laborator;</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe sylabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Programi Master i shkencave në “Teknik laborator” synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara në profilin teknik laborator, dhe të formojë studentët me kompetencën e nevojshme profesionale teorike dhe praktike, në fusha të specializuara të teknikës laboratorike.</p> <p>Në sylabuset e lëndëve janë të përshkruara objektivat e lëndës, kompetencat dhe aftësitë që do të fitojë student në fund të saj. Në përfundim të lëndës pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme orën e fundit të mësimit, pedagogu si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Gjithashtu pedagogu ndalet në vecanti në temat që kanë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkesë të studentëve.</p> <p>Evidenca nr 43. Program mësimor Msc teknik laborator;</p> <p>Evidenca nr 46. Sylabus Msc teknik laborator;</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në</p>	<p>Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore institucioni organizon leksione të hapura apo seminare jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të njihen me personalitete në fushën e menaxhimit shëndetësor. Një vënd të rëndësishëm në program zë praktika profesionale në spitalin rajonal Vlorë dhe klinikat laboratorike që janë në bashkëpunim me KUR, ku studentët bashkojnë teorinë e marrë në auditor me skenarët realist, si dhe fitojnë aftësi dhe kompetencë për ushtrimin e profesionit të teknikut laboratorit. Një</p>

<p>interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>ndër mënyrat që motivon studentët në asimilimin e programit mësimor është edhe puna e pavarur e studentit, puna në grup gjatë seminare apo aktivitetve trainuese të cila ju mundësojnë studentëve aftësitë organizuese dhe drejtuese komunikimit me etike midis kolegëve. Në zhvillimin e procesit mësimor liria akademike që siguron institucioni, ju mundëson pedagogëve përdorimin e metodave të ndryshme në mësimdhënie, në punimin e temave të diplomës. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentë në bashkëpunim me pedagogët. Këtij qëllimi i shërbejnë angazhimi që KUR ju bën studentëve në projektet shkencore që IAL zbaton në bashkëpunim me aktorë brenda apo jashtë vendit, si në konfeenca ndërkombëtare.</p> <p>Evidenca nr 43. Program mësimor Msc teknik laborator;</p> <p>Evidenca nr 46. Syllabus Msc teknik laborator;</p> <p>Evidenca 91. Raport vjetor i kërkimit shkencor 2023-2024;</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik efektiv dhe me kontratë në KUR realizon orë të hapura, seminare dhe ëëbinare për tu njohur me të reja të shkencës dhe teknologjisë në fushën e diagnostikës mjeksore dhe asaj laboratorike në vecanti. IAL ka organizuar edhe seminare ndërkombëtare në bashkëpunim me IAL italiane.</p> <p>Evidenca 91. Raport vjetor i kërkimit shkencor 2023-2024;</p> <p>Evidenca nr84. Seminar International bilateral Uni. Salerno – Uni. Reald</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në terren ka vërejtur që KUR si një institucion relativisht i ri ka qendër të vëmendjes kërkimin shkencor. Në këtë drejtim kanë vëmendjen e tyre dhe studentët, të cilët janë të përfshirë në projekte të IAL.</p> <p>Takim me studentët; Evidenca 91. Raport vjetor i kërkimit shkencor 2023-2024;</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Organizmi i programit mësimor si dhe kurikulat e programit/ sylabuset/ lëndët mësimorë mundësojnë formimin të thelluar profesional dhe zhvillim të aftësive të vecanta si aftësi organizative, kërkim të pavarur shkencor, punën në grup në fushën e teknikës laboratorike. Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteve shkencore institucioni organizon leksione të hapura apo seminare jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e teknikës laboratorike apo të shkëmbejnë</i></p>

	<i>eksperiencat dhe dijet tyre. Institucioni mbështet studentët për kërkimin shkencor duke i bërë pjesë të projekteve që ka IAL.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	<p>Studenti me përfundimin e studimeve pajiset me diplome Master shkencor në “Teknik laborator” pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur mikrotezën. Procedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet në rregulloren themelore të KUR, statutin e KUR, si dhe në rregulloren e programit të studimit Msc në Teknik laborator. Këto rregulla ju bëhen me dije studentit në fillim të vitit akademik si dhe janë publike në web faqen e Kolegjit Universitar Reald.</p> <p>Evidenca nr 2. Statuti i Kolegjit Universitar Reald; Evidenca nr 4. Rregullore e përgjithshme e KUR; Evidenca nr 6. Rregullore e programit Msc teknik laborator;</p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Koordinatori i programit, Përgjegjësi i Departamentit dhe udhëheqësit e temave të diplomave asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse – provimit përmbyllës përmes diplomës. Udhëheqësit e temave përcaktohen nga departamenti.</p> <p>Evidenca nr 4. Rregullore e përgjithshme e KUR; Evidenca nr 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjeksore.</p>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	<p>Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike përmes tezës së mbrojtjes së diplomës. Komisioni përbëhet nga 5 vetë dhe përcaktohet me vendim Dekani.</p> <p>Evidenca nr 4. Rregullore e përgjithshme e KUR; Evidenca nr 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjeksore.</p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Nga biseda me studentët e programit të studimit dhe të personelit akademik që japin mësim dhe janë udhëheqës teze, vërehet se udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe sigurohet që të jetë i plotësuar përpara paraqitjes në komisionin përkatës.</p> <p>Takimi me studentët; Takimi me personelin akademik; Evidenca nr 4. Rregullore e përgjithshme e KUR; Evidenca nr 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>KUR ka krijuar infrastrukturën e duhur laboratorike brenda institucionit, si edhe infrastrukturën në institucionet partnere brenda dhe jashtë vendit, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Spitali rajonal Vlorë, - Poliklinika qendrore Vlorë, - Marrëveshje me Universitetin e Salernos, - Klinika mjeksore dhe laboratorë mjeksorë privatë <p>me të cilët KUR ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>GVJ u njoh me disa marrëveshje bashkëpunimi me institucionet shëndetësore dhe laboratorë mjeksor për realizimin e praktikës profesionale në dokumentacionin e dorëzuar.</i></p> <p>Evidenca 29. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet publike dhe private për praktikën profesionale të studentëve; Evidenca nr 26. Marrëveshje me Universitetin e Salernos.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Studentët e programi të studimit Msc Teknik laborator në përfundim të studimeve kryejnë mbrojtjen e diplomës dhe bazuar në sylabusin e lëndëve vlerësohet me notë njësoj si lëndët e tjera të programit. Tema e diplomës vlerësohet sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Evidenca nr 4. Rregullore e përgjithshme e KUR; Evidenca nr 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me</p>	<p>Cdo student hyn në mbrojtje e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike. Pasi ka shlyer detyrimet dhe mbrojtjen e</p>

<p>diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>diplomes, student pajiset me diplomën përkatëse si dokument zyrtar, i cili nënshkruhet nga Rektori dhe Dekani i fakultetit. Tërheqja e diplomës dhe suplementit tërhiqet nga vetë student i cili nënshkruan në regjistrin përkatës.</p> <p>Evidenca nr 4. Rregullore e përgjithshme e KUR; Evidenca nr 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore; Evidenca nr 11. Rregullore e Diplomimit të studentëve.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Nga vizita në Sekretarinë Mësimore vërejmë që institucioni ruan kopje fizike dhe elektronike të të dhënave të studentit. Dokumentacioni ruhet sipas dispozitave ligjore dhe rregulloreve të brendshme. Sekretaria ka dhe mban regjistrin me të dhënat e numrit të studentëve dhe numrin e matrikullimit. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave për studentët, që i shënon në regjistrin bazë të të dhënave personale të studentëve të regjistruar, transferuar apo diplomuar. Procesi i ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave për studentët bazohet në parimin e ruajtjes së konfidencialitetit në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Institucioni përdor platformën elektronike që kryen digitalizimin e dokumentacionit sipas njësive bazë.</p> <p>Evidenca nr 14. Rregullore e standartizimit të procedurave për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentave; Evidencë nr 56. Suplement diplome Msc teknik laborator; Evidenca nr 55. Model liste notash në programin teknik laborator.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KUR ka të përcaktuar qartë procedurat e mbylljes së studimeve, mbrojtjen e diplomës apo të provimit të formimit. Stafit akademik asiston studentët gjatë gjithë procesit të mbrojtjes së diplomës. KUR pajis studentët me diplomën sipas standardit të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, së bashku me suplementin e saj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

41

Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	N / A			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	N / A			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N / A			
Konkluzione	N / A			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Program Master Shkencor në “Teknikë laboratorit” realizohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore.

Struktura organizative e departamentit përbëhet nga stafi akademik dhe ndihmës. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore ka angazhuar në programin e studimit personel akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, grada shkencore, Msc. dhe staf ndihmës akademik. Programi mësimor është hapur me urdhërin Nr. 385, datë 08.07.2022, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, por në vitin e parë akademik 2022-2023 nuk ka patur student, kështu që viti akademik mësimor në këtë program ka filluar në vitin akademik 2023-2024.

Konkretisht në këtë program studimi sipas viteve stafi akademik është si vijon:

- Për vitin akademik 2023-2024 janë angazhuar 9 (nëntë) staf akademik: 6 (gjashtë) janë PAE prej të cilëve 5 (pesë) janë Dr. dhe 1 (një) Msc. Ndërsa 3 (tre) janë PAK prej të cilëve 2 (dy) janë Prof. Asc dhe 1 (një) është Dr.
- Për vitin akademik 2024-2025 janë angazhuar 14 (katërmëdhjetë) staf akademik: 8 (tetë) janë PAE prej të cilëve 6 (gjashtë) janë Dr. dhe 2 (dy) janë Msc. Ndërsa 6 (gjashtë) janë PAK prej të cilëve 3 (tre) janë Prof. Asc dhe 3 (tre) janë DR.

Fusha e formimit profesional të personelit akademik ne disa raste nuk përputhet me lëndët që ata realizojnë në këtë program studimi. Pedagog me formim Mjek Psikiatër zhvillon lëndën “Testet laboratorike në obstetrikë-gjinekologji”, staf akademik me formim Biologji zhvillon lëndën “Testet laboratorike në geriatrikë”, apo pedagog me formim në Shkencat e Natyrës zhvillon lëndë mjekësore si “Biokimi klinike e avancuar”.

GVJ, duke u bazuar në këto të dhëna, evidenton që:

- Insitucioni ka angazhuar në mësimdhënie personel akademik me Msc. gjë e cila nuk është në përputhje me

	<p>nenin 59, pika 6 të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Në programet e nivelit të dytë mund të angazhohet vetëm personel akademik i kategorisë lektor dhe profesor.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Formimi profesional i pedagogut nuk perputhet me lëndën që ai zhvillon, apo pedagog me formim jo mjekësor zhvillojnë lëndë mjekësore. <p>GVJ rekomandon rekrutimin e stafit akademik me formim mjekësor në përputhje me lëndët që do të zhvillojnë në programin mësimor si dhe mos angazhimin e stafit akademik me Msc.</p> <p>Evidenca 15. Tabelat përmbledhëse Aneks, Evidenca 48. Stafit akademik i angazhuar ne programin e studimit Msc. Teknik Laboratori</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Për vitin akademik 2023-2024 PAE kanë realizuar 60.83% të programit mësimor. Nuk ka të dhëna për ngarkesën mësimore për vitet akademik 2024-25. Stafit akademik efektiv duhet të realizoj 70% të ngarkesës mësimore sipas akteve ligjore në fuqi dhe në këtë rast kjo nuk është respektuar nga KUR.</p> <p>Evidenca 15. Tabelat përmbledhëse Aneks,(tabela 4).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacion e shqyrtuar në Zyrën e Burimeve Njerëzore, Departamentin e Shkencave Teknike Mjekësore ku zhvillohet programi i studimit si dhe CV e stafit akademik konstaton se në vitin e dytë ka shtim të stafit akademik me grada shkencore dhe tituj. Nga shqyrtimi me përzgjedhje rastësore të kontratave të punës konstatohet se janë paguar rregullisht sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit ngarkuar ne sistemin e ASCAL mungojne CV e një pjese të stafit akademik.</p> <p>Evidenca 115 Kontratatat tip të punës; Takimi me zyrën e burimeve njerëzore.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në</p>	<p>GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK dhe pedagogë të ri me kontratë. GVJ verifikoi me përzgjedhje rastësore dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë dhe staf i ri akademik me kontratë.</p> <p>Institucioni disponon praktikë të veçantë në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga Kolegji Universitar Reald.</p>

përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.

Procedura e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë apo të pjesshme realizohen nga njësia bazë duke propozuar komisione Ad-hoc konform bazës ligjore dhe nënligjore si dhe akteve të brendshme rregullatore të IAL. Procedurat e rekrutimit të personelit janë transparente, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në statusin dhe rregulloren e institucionit. Kolegji Universitar Reald përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik; procedura u verifikua nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion dhe nga takimet e realizuara me titullarët. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me sistem pikëzimi.

Nga shqyrtimi me përzgjedhje rastësore të dosjeve të personelit GVJ konstatoi se është i pranishëm dokumentacioni i kërkuar.

Konkretisht, dosja e stafit akademik përmban:

1. Kontrata e punës;
2. Dokumentacionin që ka dorëzuar në momentin e aplikimit;
3. Librezën e punës;
4. CV;
5. Listë notash, Diplomë, dëshmi penaliteti, raport mjeko ligjor ;
6. Fotokopje ID.
7. Diplomat e gjuhës së huaj vendosen
8. Certifikata kualifikimesh, trainime, pjesmarrje në konferenca etj

Çdo vit departamentet bëjnë përcaktimin e stafit akademik që përfshihet në programin e studimit, ngarkesën mësimore sipas semestrave dhe atë vjetore. Në bazë të ngarkesës mësimore departamenti bën planifikimin e pedagogëve si dhe i paraqet dekanatit nëse ka nevoja për rekrutim të stafit akademik dhe jo akademik për realizimin e programit të studimit, gjithashtu departamenti harton kriteret bazë dhe specifike.

Pasi miratohen në rektorat vendet e lira të punës shpallen në faqen e ëeb-it të universitetit ku publikohen kriteret e përgjithshme dhe specifike për vendin e punës si dhe dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga çdo kandidat, afatet kohore për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm si dhe tabela e pikëzimit të kandidatit. Pas shpalljes së vendit vakant, dekani ngre komisionin "ad hoc" që do të realizojë procedurën për rekrutimin e stafit akademik. Konkurrimi kalon në dy faza:

1. Vlerësim në bazë të dosjes;
2. Intervista me gojë.

	<p>Kandidatët klasifikohen sipas pikëve dhe merret vendimi përkatës.</p> <p>Evidenca 52. Rregullre e burimeve njerëzore.</p> <p>Evidenca 47. Praktike rekrutimi e stafit akademik - viti akademik 2022-2023.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ evidentoi se nuk ka personeli ndihmës akademik që asiston dhe realizon orët laboratorike, pasi ende nuk janë ngritur labororet mjekësor biokimik klinik, mikrobiologjik dhe histologjise.</p> <p>Evidenca 15. Tabelat përmbledhëse Aneks</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se Kolegji Universitar REALD disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit. Çdo vit Zyra e Burimeve Njerëzore bën dhe përditësimet në bazën elektronike të të dhënave dhe dokumentacionit plotësues përkatës. Institucioni ka venë në dispozicion listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe ngarkesën e tyre mësimore, kualifikimin e tyre.</p> <p>Takimi me stafin e burimeve njerëzore, Evidenca 15. Tabelat përmbledhëse Aneks</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e</p>	<p>Për kryerjen e orëve të praktikës profesionale sipas programit të studimit FSHM dhe KUR ka lidhur marrëveshje me institucione të tjera të Arsimit të Lartë dhe Institucione të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor. Konkretisht GVJ evidentoi që KUR ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet IAL si Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali", Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Albania University, Universiteti European Tiranës, Universiteti Fogias, Salemos, Mesinës, Universiteti Aldo Moro, Bari, spitali Rajonal Vlore, Spitali Psikiatrik Halil Mihali, Vlorë, Spitali Rajonal Fier, Laboratorët mjekësor në Vlorë si Novida, Izident, Lupa, Dielli,</p>

<p>diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Klinikat mjekësorë si Medical, Gega, Bakaj, Poliklinika Qëndrore Vlorë.</p> <p>Marrëveshjet kanë si qëllim kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor dhe gjithashtu realizimin e diplomës. Marrëveshjet janë të lidhura në nivel Instucional dhe zbatohen nga njësia bazë.</p> <p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se IAL ka vënë në dispozicion disa marrveshshje në funksion të programit të studimit. GVJ rekomandon rishikimin e marrëveshjeve që ju ka mbaruar afati bashkepunimit.</i></p> <p>Evidenca 25. Lista e IAL-ve me të cilat KUR ka marrëveshje bashkëpunimi, Evidenca 29. Lista e marreveshjeve te bashkepunimit me institucione publike dhe private per praktiken profesionale te studenteve. Evidenca 26. Marrëveshje me Universitetin e Salernos 2022. Evidenca 27. Marrëveshja me Universitetin e Vlores dhe Aneksi 1. i Marreveshjes. Evidenca 28. Marreveshje bashkepunimi REALD - Albanian University.pdf</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin prites që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Institucioni ka një procedurë të përcaktuar për përcaktimin e udhëheqësve të praktikave klinike që përzgjidhen nga drejtuesit e institucioneve ku realizohet praktika klinike në bazë të marveshjeve të lidhura. Personeli mbikqyrës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në programin e studimit Master Shkencor “Teknikë Laboratori” ndihmon studentët si në përmbushjen e detyrimeve/raportit përfundimtar të praktikës gjithashtu dhe në vlerësimin e tyre. Praktika e detyrueshme mbikëqyret bashkarisht nga mbikëqyrësi laboranti referent/kryelaborant në vendin e praktikës dhe kordinatori/pedagogu i caktuar i stafit akademik i departamentit.</p> <p>Evidenca 20. Libri i Praktikes Klinike ne programin Msc. Teknik Laboratori.pdf</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi mësimor është hapur në vitin 2022, por në vitin e parë akademik 2022-2023 nuk ka patur student, kështu që viti akademik mësimor në këtë program ka filluar në vitin akademik 2023-2024. Struktura organizative e departamentit ku zhvillohet programi i studimit Msc në Teknik Laboratori përbëhet nga stafi akademik dhe ndihmwrs akademik/ personeli mbështetës për realizimin e praktikave mwsimore nw laboratorwt mjekwsor.</i></p>

	<p><i>Institucioni ka angazhuar në mësimdhënie personel akademik me Msc. gjë e cila nuk është në përputhje me aktet ligjore. Gjithashtu në këtë program studimi ka pedagog formimi profesional i të cilëve nuk përputhet me lëndën që zhvillojnë, apo pedagog me formim jo mjekësor zhvillojnë lëndë mjekësore. Staf i akademik efektiv realizon 60% të ngarkesës mësimore, në shkëlqim të akteve ligjore. Procedurat e rekrutimit të personelit janë transparente, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në statusin dhe rregulloren e institucionit. Institucioni ka një procedurë të përcaktuar për përcaktimin e udhëheqësve të praktikave klinike që përzgjidhen nga drejtuesit e institucioneve ku realizohet praktika klinike në bazë të marveshjeve të lidhura dhe një pedagog nga fakulteti i shkencave mjekësore</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh më mjediset e KUR. Mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, biblioteka, shërbimet për studentët, janë të përshtatshme për zhvillimin e një procesi normal mësimor.</p> <p>Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme, sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimorë, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin, bibliotekë si dhe hapësirë të jashtme në ambiente të tjera dhe parking.</p> <p>Njësia bazë ka në dispozicion mjedise të mjaftueshme, për zhvillimin e veprimtarisë mësimore laboratorike dhe administrative. Institucioni disponon sistem ngrohje-ftohje qendrore, sistem sigurimi pa ndërprerje të energjisë elektrike, nyje hidrosanitare, sistem të mbrojtjes kundër zjarrit, sistem sigurie dhe vëzhgimi të ambienteve të cilat u verifikuan dhe gjatë vizitës në institucion</p> <p>Evidenca 95. Infrastruktura akademike. Vizita në institucion.</p>

	Evidenca 101. Lista e mjeteve didaktike në KUR., 102. Lista e aseteve te luajtshme ne IAL.
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në ambientet e KUR konstatoi se ambientet e mësimdhënies janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. KUR zotëron dy godina për zhvillimin e procesit akademik në te cilat janë funksionale 5 salla leksionesh dhe seminaresh me kapacitet 25-60 poste/vende, një sallë konferencash me kapacitet 100 vëndesh te paisur me mjere audiovizive, katër laboratorë. Sallat e leksioneve dhe seminareve kanë numrin e mjaftueshëm të posteve për studentët të cilët janë të organizuarar në grupe në raport me numrin e posteve në sallë. Ambjentet mësimore janë me sistem kondicionimi ngrohje dhe ftohje. Në funksioin të programit janë në dispozicion mjete elektronike dhe teknologjisë së informacionit, si kompjutera kompjuter të lidhur me internet dhe tabela, videoprojektorë në të gjitha sallat. Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore.</p> <p>Salla e informatikës është në shërbim të vazhdueshëm të studentëve më qëllim realizimin sa me të mirë të procesit akademik. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim.</p> <p>Evidenca 95. Infrastruktura akademike. Vizita e ambjenteve.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në funksion të programit të studimit janë Laboratorët mësimorë (laboratroi i anatomisë, fizioterapisë, kimisë, kimisë farmaceutike, farmacisë, stomatologjisë, klinika dentare, laboratroi informatkës), të mirëpajisur me aparatura, mjete pune, mjete didaktike dhe reagentë në funksion të procedimit të metodave laboratorike përfshirë në programin e studimit.</p> <p><i>Konkretisht në funksion të këtij program studimi, mungojnë Laboratorët mjekësorë mësimor Biokimik Klinik, Mikrobiologjik apo histologjisë për zhvillimin e praktikës mësimore.</i> Në takim me drejtuesit e njësisë kryesore dhe Universitetit u tha se janë në proces të blerjes së paisjeve mjekësore për këta laboratorë. Nga drejtuesit e programit u referua se aktualisht praktika mësimore realizohet në laboratorët mjekësorë me të cilat IAL ka marrëveshje bashkëpunimi. GVJ rekomandon ngritjen sa më shpejtë e laboratorëve mjekësor për realizimin e programit mësimor.</p>

	Evidenca 95. Infrastruktura akademike. Evidenca 96. Labororet ne IAL Vizita e ambjenteve.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	<p>Institucioni ka të instaluar një laborator informatike të pajisur me kompjutera, pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, programe profesionale për laboratorët e informatikës dhe Statistikës dhe ka dispozicion programe bazë dhe të SPSS ne funksion të përpunimeve statistikore dhe kërkimit shkencor sipas programit të studimit.</p> <p>Evidenca 95. Infrastruktura akademike. Evidenca 96. Labororet ne IAL. Evidenca 97. Rack-u i lidhjes në rrjet dhe Laboratori i Informatikës ne IAL.Vizita e ambjenteve.</p>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulate me kapacitetet e nevojshme.	<p>Për kryerjen e orëve të praktikës profesionale sipas programit të studimit KUR ka në zbatim marrëveshje bashkëpunimi me institucione të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor si spitali Rajonal Vlorë, Spitali Psikiatrik Halil Mihali, Vlorë, Spitali Rajonal Fier, Laboratorët mjekësor në Vlorë si Novida, Izident, Lupa, Dielli, Klinikat mjekësore si Medical, Gega, Bakaj, Poliklinika Qëndrore Vlorë</p> <p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se është e pranishme lista e marrëveshjeve me institucionet shëndetësore si dhe disa marrveshshje në funksion te programit te studimit. GVJ rekomandon rishikimin e marreveshjeve që ju ka mbaruar afati.</i></p> <p>Evidenca 29. Lista e marreveshjeve te bashkepunimit me institucione publike dhe private per praktiken profesionale te studenteve.pdf 30. Model - Marrëveshje bashkepunimi per kryerjen e praktikës profesionale me Klinika BAKAJ.</p>
Konkluzione	<p><i>Mjediset e KUR. Mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, biblioteka, shërbimet për studentët, janë të përshtatshme për zhvillimin e një procesi normal mësimor. Mungojnë Laboratorët mjekësorë mësimor për zhvillimin e praktikës mësimore. Aktualisht praktika mësimore realizohet në laboratorët mjekësorë me të cilat IAL ka marrëveshje bashkëpunimi. Rekomandojmë Ngritjen sa më shpejtë e laboratorëve mjekësor për realizimin e programit mësimor.</i></p>

	<i>GVJ konstaton se është e pranishme lista e marveshjeve me institucionet shëndetësore dhe disa marrveshje ne funksion te programit te studimit për realizimin e praktikës profesionale Rekomandojmë rishikimin e marreveshjeve qe ju ka mbaruar afati.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Institucioni disponon një sallë biblioteke të pajisur me 20 vende leximi dhe vendi interneti të pajisura me kompjutera. Biblioteka disponon mbi 2500 botime/titujsh librash profesional, prej të cilave 174 i përkasin shkencave mjekësore. Gjatë vitit 2020-2021 bibliotekës i janë shtuar dhe 500 librat ne fondin me 42 tituj të rinj ku 14 tituj janë në fushën e mjekësisë në gjuhën shqipe dhe të huaj në funksion të prognameve mësimore të shkencave mjekësore. Në funksion të procesit mësimor përvec librave fizik është dhe biblioteka online e cila ofron një gamë të gjërë tekesh(936 libra) dhe botime në gjuhën shqipe dhe angleze e cila është e aksesueshme për studentët dhe stafin akademik.</p> <p>Evidenca 98. Lista e librave ne fushen e shkencave mjekesore qe ndodhen ne Bibliotenen e IAL.</p> <p>Evidenca 99. Lista e librave të rinj të shtuar në Bibliotekën e IAL.</p> <p>Evidenca 100. Biblioteka On-Line me libra te disponueshem ne biblioteken e IAL.</p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Gjatë takimeve me stafin drejtues dhe në RVB thuhet se njësia përgjegjese kontribuon vazhdimisht në përditësimin dhe pasurimin e literaturës në funksion të programit të studimit. Në bazë të kërkesave të njësisë bazë Institucioni akordon çdo vit një fond të përshtatshëm për pasurimin me literaturë bashkëkohore. Departamenti rishikon në fillim të çdo viti akademik literaturën në syllabuse me qëllim rifreskimit e tyre në bazë të traktateve mjekësore bashkëkohore.

	<p>Takimi me stafin drejtues; Vizita e Ambjenteve të bibliotekes, Evidenca 98. Lista e librave ne fushen e shkencave mjekesore qe ndodhen ne Biblioteken e IAL.</p> <p>Evidenca 99. Lista e librave të rinj të shtuar në Bibliotekën e IAL</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>KUR ka një Bibliotekë Universitare pranë godinës kryesore e cila ka hapësira të dedikuara dhe të bollshme për studentët, poste të paisura me kompjureta te lidhura me internetin. Gjithashtu KUR ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentët mund të konsultohen me materiale ndërkombetare.</p> <p>Evidenca 100. Biblioteka On-Line me libra te disponueshem ne biblioteken e IAL. Vizita e ambjenteve.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës GVJ evidentoi që Biblioteka e Kolegjit Universitar Reald ka nje fond fizik të bollshëm të literaturës mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të huaja, libra apo revista shkencore si dhe botime të ndryshme. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në Instiucionin vihet re rritje e vazhdueshme vit pas vitit të buxhetimit të bibliotekës me qëllim vazhdimin e pasurimit të saj. GVJ inkurajon Instiucionin për rritje të vazhdueshme vit pas vitit të buxhetimit të bibliotekës me qëllim vazhdimin e pasurimit të saj, por një vëmendje e vecantë duhet ti kushtohet sigurimit të tekseve mësimor apo udhëzuesve për teknikat laboratorike mjekësorë.</p> <p>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët.</p> <p>Evidenca 98. Lista e librave ne fushen e shkencave mjekesore qe ndodhen ne Bibliotenen e IAL.</p> <p>Evidenca 99. Lista e librave të rinj të shtuar në Bibliotekën e IAL Vizita e ambjenteve.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>KUR ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë, si të bibliotekës fizike ashtu dhe asaj on-line.</p> <p>Biblioteka siguron literaturë fizike dhe digjitale/on line në ndihmë të studentëve dhe stafit akademik. Gjithashtu, KUR ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentet mund të konsultohen me materiale në gjuhë të huaj ne keto adresa (http://www.freebooks4doctors.com/f.php?f=hiv; http://www.freemedicaljournals.com/)</p> <p>Evidenca 100. Biblioteka On-Line me libra te disponueshem ne biblioteken e IAL.pdf</p>

<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. Biblioteka është e pajisur me kompjutera, dhe programe dixhitale, fotokopje, printera, internet që mundëson shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p> <p>Vizita e ambienteve.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. Gjatë vizitës në institucion, nga GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara, dhe në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Biblioteka është e hapur çdo ditë nga 8.00 deri në orën 16:00.</p> <p>Institucioni ka punonjës të veçantë për bibliotekën i cili përgjigjet për mirëmbajtjen dhe nevojave të studentëve. Studentët pajisen me kartë rregjistrimi dhe njihen me rregulloren e funksionimit të bibliotekës.</p> <p>Vizita e ambienteve</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Biblioteka menaxhohet nga një person përgjegjës i cili bën raportimin e vazhdueshëm në lidhje me përditësimin e literaturës, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe on line etj. Biblioteka është e pajisur me sistem kompjuterik të menaxhimit të titujve. KUR planifikon çdo vit buxhet të veçantë për pasurimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj apo përditësim të fondit ekzistues në funksion të programeve mësimore.</p> <p>Propozimet për titujt apo tekse vijnë nga departamentet e fakulteteve dhe përgatiten nga stafi i bibliotekës i cili përgatit listën e tekseve të kërkuara me buxhetin përkatës dhe dorëzon në rektorat. Gjatë bisedës me stafin akademik dhe studentët u deklarua se ata e shfrytëzojnë në mënyrë të kënaqshme fondin e bibliotekës kryesisht atë on-line.</p> <p>Bazuar në deklaratimet e studentëve dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, ata shprehën pozitivisht për ndihmën dhe mbështetjen e stafit akademik në sigurimin e tekseve, leksione apo literature ndihmëse që ju nevojitet gjatë vitit akademik.</p> <p>Takimi me stafin dhe studentet.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni disponon një sallë bibliotekë të pajisur me vende leximi dhe vendi interneti të pajisura me kompjutera. Fondi i Bibliotekës është i bollshëm dhe i pasuruar me libra të rinj në fushën</i></p>

	<p>e mjekësisë në gjuhën shqipe dhe të huaj në funksion të programeve mësimore të shkencave mjekësore.</p> <p>KUR planifikon çdo vit buxhet të veçantë për pasurimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj apo përditësim të fondit ekzistues në funksion të programeve mësimore.</p> <p>GVJ inkurajon Instiucionin për rritje të vazhdueshme vit pas vitit të buxhetimit të bibliotekës me qëllim vazhdimin e pasurimit të saj, por një vëmendje e vecantë duhet ti kushtohet sigurimit të tekseve mësimor apo udhëzuesve për teknikat laboratorike mjekësorë</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>KUR disponon sistem menaxhimi elektronik nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, systemin. Ky sistem është një platformë ku koordinohen të dhënat e sekretarisë mësimore, stafit akademik dhe studentëve me akses të caktuar ndaj informacionit.</p> <p>Sekretaria mësimore dokumentacionin e ruan në dy forma shkresore dhe elektronike. Ajo është përgjegjëse për regjistrat, hedhjen e të dhënave dhe për marrëdhëniet me studentët. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale merr informacion për rezultatet e provimeve, regjistrohet në lëndët që do të frekuentojë apo provimet që do të jap gjatë vitit akademik.</p> <p>Sekretaria mësimor ka në formë shkresore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regjistrin themeltar të studentëve; • Regjistrin me të dhënat akademike; • Regjistrin e lëshimit të diplomave. <p>Regjistrat ruhen pa afat dhe arkivohen në arkivën e shtetit. Sekretaria mësimore arkivon:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Dosjet e pranimit dhe regjistrimit të studentëve me gjithë dokumentacionin përkatës; • Procesverbalet e testeve në provime; • Dosjet e diplomimit; • Dokumentacioni që verifikon plotësimin e kushteve për diploma, procesverbalet e notave të provimit/temave të diplomës; • Listën e të diplomuarve përcjellë rektoratit për miratim, fotokopje të diplomave të tërhequra. <p>Në sistem elektronik kanë akses pedagogët, studentët, sekretaria mësimore, dekani i fakultetit.</p> <p>Takimi me stafin e sekretarisë mësimore, stafin drejtues të FSHM. Evidence 103. Database për ruajtjen e të dhënave dhe dokumentave të studenteve në rrugë elektronike - në gjuhën shqipe.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Institucioni ka dokumentacion të plotë lidhur me stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativë të angazhuar në realizimin e programit mësimor. Gjatë vizitës në institucion u verifikua se Institucioni ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit, i cili të funksionojë në bazë të rregullore të miratuar nga Senati Akademik me nr 36, datë 1.06.2020.</p> <p>Evidenca 14. Rregullore e standardizimit të procedurave për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve - 2020.</p> <p>Evidenca 37. Vendim SA nr. 36 date 01-06-2020 - miratim i Strategjisë së Zhvillimit +Rregullore për Standardizimin e Dokumenteve.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin e sekretarisë GVJ konstaton se insitucioni disponon një sistem menaxhimi për komunikim student personel mbështetës lidhur me informacionin apo dokumenta midis tyre.</p> <p>Institucioni ka një informacion të plotë për studentët dhe stafin akademik. Ky sistem menaxhimi për adminsitrimin e informacionit është dhe në format fizik dhe elektronik në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj italisht për programe që zhvillohen në gjuhën italiane, i cili administrohet nga sekretaria mësimore.</p> <p>Stafi akademik dhe studentët kanë akses për infomacione apo dokumenta të nevojshëm në dobi të programit të studimit. Në sistemin elektronik, në regjistrat e sekretarisë dhe në zyrat e sekretarisë së titullarit të njësive kryesore (fakultetit) pasqyrohen,</p>

	<p>administrohen dhe ruhen të dhëna dhe informacione, dokumentacione të studentëve që ndjekin studimet dhe të dhëna të rezultateve gjatë viteve të studimit, të dhëna për personelin akademik dhe ndihmës akademik dhe administrativ, programet e studimit kurrikular, të dhëna financiare në lidhje me tarifat e studentëve dhe pagesat e kryera. Aksesit në sistem bëhet në mënyrë të dedikuar në varësi të statusit akademik dhe administrativ.</p> <p>Në këtë sistem kanë profilin e tyre dhe akses të gjithë studentët, i gjithë stafi akademik efektiv dhe me kontratë. Gjithashtu, institucioni u ka vënë në shërbim të gjithë studentëve dhe stafit akademik adresat e emailit (emërmbiemër@unireald.edu.al) i cili shërben për komunikimin e brendshëm institucional dhe të jashtëm.</p> <p>Evidenca 63. Regjistri i notave të studentëve Msc. Teknik Laboratori.</p> <p>Evidenca 64. Regjister i leshimit të diplomave në programin Msc. Teknik Laboratori.pdf</p> <p>Evidenca 103. Database për ruajtjen e të dhënave dhe dokumentave të studentëve në rrugë elektronike - në gjuhën shqipe.</p> <p>Evidenca 104. Database për ruajtjen e të dhënave dhe dokumentave të studentëve në rrugë elektronike- në gjuhë të huaj.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për studentët dhe pedagogët.</p> <p>Komunikimi midis stafin akademik studentë realizohet nëpërmjet e-mail, platformës ëëë.unireald.edu.al i cili siguron komunikim interaktiv midis studentëve dhe pedagogëve apo platforma on line Goole clasroom, për të ciln janë hartuar dhe udhësuesit përkatës . Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik, apo kanë një kod personal ku aksesojnë literaturën mësimore online. Gjithashtu pedagogët kanë hapësirën e tyre në Platforma Online ku komunikojnë me studentët në lidhje me materialet e leksioneve, moduleve, projekteve mësimore etj. Platforma siguron një komunikim interaktiv ndërmjet studentëve dhe pedagogëve</p> <p>Takimi me studentet dhe staf akademik, Evidenca 105. Platforma e komunikimit elektronik në IAL.</p> <p>Evidenca 16. Google Classroom Manuali student.</p>

	Evidenca 17. Manual për programin OBS për regjistrim Video dhe audio. Evidenca 18. Google Classroom Manual pedagogu.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e 57ministrative dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Institucioni ka krijuar infrastrukturën për monitorimin e e aktivitetit akademik dhe administrativ apo raportimin e brëndshëm që realizohet nëpërmejt komunikimit me emalin e brenshëm zyrtar emer.mbiemer@unireald.edu.al Në sistemin e menaxhimit kanë llogari sekretaria mësimore dhe autoritetet drejtuese duke krijuar mundësinë e monotorimit në kohë reale të të gjitha të dhënave dhe mundësinë e gjenerimit e raporteve në lidhje me frekuentimin, rezultatet, etj. Kjo llogari mundëson pasqyrimin e aktivitetit akademik semestral dhe komunikimin midis stafit për problematikat që lindin nga pasqyrimi i vlerësimit në sistem. Takimi me studentet dhe staf akademik, Evidenca 105. Platforma e komunikimit eletronik ne IAL			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Institucioni disponon faqen e tij të internetit [ëëë.unireald.edu.al] e cila përmban informacione të vlefshme për informimin e publikut. Faqja e internetit ofrohet në gjuhën shqipe,anglisht dhe italisht. Informacionet në lidhje me programet e studimit, kërkimin shkencor, planin mësimor, kalendarine provimeve, strukturën/organigramën përditësohen dhe publikohen ne faqen e universitetit. Faqja e universitetit, takimi me stafin drejtues dhe akademik.			
Konkluzione	<i>KUR disponon sistem menaxhimi elektronik nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Sistemi komunikimit elektronik është një platformë ku koordinohen të dhënat e sekretarisë mësimore, stafit akademik dhe studentëve me akses të caktuar ndaj informacionit. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik. Platforma siguron një komunikim interaktiv ndërmjet studentëve dhe pedagogëve. Institucioni disponon faqen e tij të internetit në gjuhën shqipe,anglisht dhe italisht cila përmban informacione të vlefshme për informimin e publikut.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Çdo vit akademik KUR harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Shpërndarja bëhet në bazë të nevojave që paraqesin njësitë kryesore në bazë të kërkesave të planifikuara në cdo fillim viti akademik.</p> <p>Evidenca 14.2: Të dhëna financiare UAL për pesë vitet e fundit.</p>
<p>Kriteri 2.Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të</p>	<p>Plani financiar përshkruan kostot e programit duke përfshirë burimet njerëzore, infrastrukturore, materialet e konsumit, përdorimin e pajisjeve laboratorike, zhvillimin e praktikave spitalore, pasurimin e bibliotekës, kostot e auditeve të brendshme dhe të jashtëm. Burime të financimit për zhvillimin e programit të studimit IAL I siguron nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të ardhurat nga tarifa e studimit të studentëve; - Të ardhurat nga projektet e përbashkëta të IAL me institucione të tjera; - Investime nga veprimtaria e biznesit të shoqërisë themeluese “ESKELD sh.p.k”. <p>Çdo vit akademik në përfundim hartohen pasqyrat financiare që tregojnë masën e realizimit të Projekt-Buxhetit të përcaktuar.</p> <p>Evidenca 112. Raport financiar mbi koston e programit të studimit Msc. Teknik Laborator.</p> <p>Evidenca 113. Raport financiar vjetor i IAL - viti 2023.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni KUR auditon në mënyre periodike aktivitetin financiar KUR funksionon si një biznes i mirëfilltë dhe i nënshtrohet procedurave ligjore financiare siç janë Bilanci Kontabël, Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve. Dokumentacioni administrohet nga zyra e financës.</p>

	Evidenca 113. Raport financiar vjetor i IAL - viti 2023. Takimi me zyrëre e financës.			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Cdo vit në analizën vjetore bën analizën financiare në nivel të njësisë bazë për programet që ajo mbulon. Në të pasqyrohet realizimi i buxhetit të parashikuar, dhe planifikimi për vitin pasardhës. Evidenca 113. Raport financiar vjetor i IAL - viti 2023. Takimi me zyrëre e financës.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Universiteti deklaron një gjëndje të qëndrueshme ekonomike me rritje graduale nga viti në vit. Nuk ka detyrime ndaj të tretëve si individë, biznese, banka, tatime apo organizata. Duke pasur një rritje të tillë Institucioni ka investuar në infrastrukturë, logjistikë, laboratorë dhe punësimin e personelit akademik cilësor me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe aktivitetit akademik. Në vlerësimin e GVJ, Institucioni demonstron qëndrueshmëri dhe kapacitete financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij në përgjithësi dhe ecurinë normale dhe me cilësi të programit MSH në Teknikë Laboratori. Evidenca 14 .2 Të dhëna financiare të UAL për 5 vitet e fundit			
Konkluzione	<i>Universiteti deklaron një gjëndje të qëndrueshme ekonomike me rritje graduale nga viti në vit. Nuk ka detyrime ndaj të tretëve si individë, biznese, banka, tatime apo organizata</i> <i>KUR harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Burime të financimit për zhvillimin e programit të studimit IAL I siguron nga: Të ardhurat nga tarifa e studimit të studentëve; Të ardhurat nga projektet e përbashkëta të IAL me institucione të tjera; Investime nga veprimtaria e biznesit të shoqërisë themeluese "ESKELD sh.p.k".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

59

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>KUR është institucion jo publik i arsimit të lartë, i cili bazon aktivitetin e tij në bazën ligjore aktuale në fuqi. Institucioni disponon akte rregullatore si Strategjia e Zhvillimit Institucional 2021 – 2026, rregulloret e njësive kryesore, njësive bazë, rregulloret e programeve mësimore etj, në përputhje me statutin e kolegjit të miratura me vendim të senatit akademik dhe Urdhër nr. 147, datë 31.03.2017 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Në këto dokumenta janë shkruar qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje të cilat janë në përputhje të plotë me Statutin e Universitetit, rregulloret e FSHM dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Në këtë dokumentacion përcaktohen procedurat e propozimit të kuotave të pranimit, procedurat e transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta. Procedurat e pranimit realizohen mbi bazën e kriterëve specifike të përcaktuara, dhe po ashtu sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit.</p> <p>Në rregulloren e FSHM, studenti gjen informacion të plotë për strukturën e fakultetit, programet e studimeve që ofrohen, organizimin e programeve, diplomimin etj. Sekretaria mësimore është në funksion të informimit dhe ndjekjes së studentit nga regjistrimi në diplomim. Pranë KUR funksionon Zyra e Këshillimit të Studentëve që ka nga një kordinator nga cdo fakultet. Informacioni udhërrëfyes për studentët gjendet dhe në faqen eeb të universitetit.</p> <p>Evidenca 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD., evidenca 3. Strategjia e Zhvillimit Institucional 2021 – 2026, Evidenca 4. Rregullore e Pergjithshme KUR - 2 018. Evidenca 5. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar. Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekësore - E ndryshuar.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje</p>	<p>FSHM ofron një mjedis të favorshëm përsa i përket respektimit të të drejtave dhe barazive të cdo individi, duke respektuar:</p>

<p>garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>shtresën sociale, përkatësinë ndaj një grupi të caktuar, orientimin seksual e identitetin gjinor, bindjen fetare, etninë etj. Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesëmarrje në aktivitete promovuese, mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme. Përzgjedhja realizohet me procedura transparente duke respektuar meritokracinë.</p> <p>Evidenca 22. Të dhënat mbi kriteret e pranimit në këtë program studimi, tarifa dhe modalitetet finaciare për studentët. Msc. Teknik Laboratori. Evidenca 6. Rregullore e Programit Msc. Teknik Laboratori.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Para çdo viti akademik bazuar në kërkesën e MAS, Institucioni përcakton kuotat dhe kriteret e përgjithshme dhe specifike në programet e studimit master. Kuotat përcaktohen bazuar në kërkesat e departamentot me miratim të senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, në përputhje me standardet shtetërore, kapaciteteve njerezore, akademike dhe ato logjistike që ka institucioni.</p> <p>Në këtë program studimi mund të aplikojnë kandidatë të cilët kanë mbaruar së paku studimet bachelor në teknikë laborator brenda apo jashtë vendit ose në fusha të tjera të përafërta. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të përafërta duhet të kenë jo më pak se 85% përputhshmëri të programeve përkatëse të studimit të ciklit të pare. Në këto kritere përfshihen dhe parashikohet edhe regjistrimi i studentëve të huaj. Në programin e studimit Master i Shkencave në "Teknikë Laboratori" kandidatët vlerësohen dhe klasifikohen në bazë të pikëzimit dhe lista e fituesve bëhet publike. Në fazat e regjistrimit, institucioni publikon kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve të cialt janë të aksesueshme nga publiku në faqen online të KUR.</p> <p>Institucioni bashkëpunon me RASH dhe QSHA për procedurat e regjistrimit dhe të transferimit të studentëve.</p> <p>Takimi me stafin drejtues te KUR, Faqja web.</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose</p>	<p>Pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet e ciklit të dytë në Kolegj bëhet në përputhje me kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes, të miratuara nga Senati Akademik.</p> <p>Në rregulloren e përgjithshmetë IAL dhe rregulloren e Fakultetit të Shkencave Mjekësore si dhe në faqen e ëebit te KUR janë paraqitur qartë e në mënyrë të kuptueshme informacionet për:</p>

<p>të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Organizimin e programeve të studimit; - Kriteret për pranimet të studentëve në ciklin e dytë; - Ndërprerjen e studimeve, procedurat e transferimit apo të ndjekjes së një programi të dytë studimi; - Rregullat e ekuivalentimit etj. <p>Procedurat e mësipërme si organizimi i programit i ekuivalentimit, transferimit të krediteve u bëhet e ditur edhe nga koordinatori i programit të studimit. Rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset kanë informacion të qartë e të detajuar për format e mësimdhënies, planin mësimor, mënyrën e kontrollit të dijeve, realizimin e praktikës dhe detyrave të kursit, procesin e diplomimit me provim/temë diplome. Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me aksesin në informacion, me funksionimin e zyrës së këshillimit të karrierës, me funksionimin e sekretarisë mësimore në ndihmë të tyre.</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e përgjithshme e IAL - e ndryshuar. Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore - E ndryshuar</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>KUR përpara fillimit të ri akademik informojnë publikun dhe të interesuarit në lidhje me programet e studimit dhe kriteret përkatëse. KUR dhe FSHM kanë në traditën e tyre organizimin e materilave informuese dhe postera për prindër dhe studentët që kanë përfunduar programin e studimit bachelorin në Teknik laborator. Materialet informuese kanë në fokus njohjen e të interesuarve me kriteret e përgjithshme dhe specifike për t'u pranuar në programet e studimit, mundësitë e shkollimit dhe punësimit pas mbarimit të programeve të studimit etj. Informacioni gjendet gjithashtu në faqen eeb të KUR.</p> <p>Evidenca 67. Kalendar i Informimit të Maturantëve. Viti 2024.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>KUR parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, gjithashtu institucioni ka hartuar politika të mbështetjes financiare për të gjitha këto shtresa.</p> <p>Evidenca 68. Tabela e kuotave të pranimit të studentëve 2024-2025.</p>

<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Pas diskutimit me drejtuesit dhe në bazë të dokumentacionit, KUR dhe Departamenti ku zhvillohet program i studimit ben pranimin e studenteve të huaj me konkurs sipas kriterëve të përcaktuar në rregulloren e programit të. Studentët e huaj duhen të kenë njohuri në gjuhën shqipe të dokumentuar me teste komëbtare. Këto kriterë janë përputhje me aktet nënligjore të MAS.</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e pergjithshme e IAL - e ndryshuar. Evidenca 33. Vendim SA per miratimin e kriterëve te pranimit te studenteve per vitin akademik 2025 - 2026.pdf</p>		
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>KUR çdo vit akademik harton dhe realizon procedura specifike të bursave dhe ndihmëse për shtresat në nevojë dhe për studentët ekselentë në varësi të arritjeve akademike. Për kategoria të nevojë dhe studentët me aftësi ndryshe KUR siguron 50% të bursës.</p> <p>Evidenca 112. Raport financiar mbi koston e programit të studimit Msc. Teknik Laboratori.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në aktet rregullatore të KUR janë shkruar qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje të cilat janë në përputhje të plotë me Satutin e Universitetit, rregulloret e FSHM dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesëmarrje në aktivitete promovuese, mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme. Procedurat e pranimit të studentëve vendas dhe të huaj në programin e studimit realizohen mbi bazën e kriterëve specifike të përcaktuara, dhe po ashtu sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit. Studentët e huaj duhen të kenë njohuri në gjuhën shqipe të dokumentuar me teste komëbtare. Kuotat përcaktohen në bazë të kapaciteteve njerezore, akademike dhe ato logjistike që ka institucioni me miratim të Senatit Akademik dhe Bordit të administrimit. KUR parashikon kuota të posaçme dhe kriterë për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, gjithashtu institucioni ka hartuar politika të mbështetjes financiare për të gjitha këto shtresa. Për kategoria të nevojë dhe studentët me aftësi ndryshe KUR siguron 50% të bursës.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Studentët informohen në fillim të vitit akademik për kriteret e kalimit nga njëri vit në tjetrin siç është numri e krediteve që duhet të grumbullojnë. Informacioni është në web dhe gjithashtu jepet nga Sekretariteti Mësimor dhe rregullorene FSHM, rregullore e programit të studimit.</p> <p>Mungesat duhet të shlyhen para vlerësimit përfundimtar të lëndës apo modulit. Në sekretarinë mësimor të FSHM mbahet regjistri i frekuentimit të procesit mësimor nga studentët e çdo grupi mësimor, i cili plotësohet për çdo orë mësimore.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore - E ndryshuar.</p> <p>Evidenca 6. Rregullore e Programit Msc. Teknik Laboratori.</p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Në rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit, studentët kanë informacion për kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Informacioni është në web dhe gjithashtu jepet nga Sekretaria Mësimore. Institucioni përmes Dekanit të FSHM ngre në departament një komision të posaçëm ad hoc të ekuivalentimit të moduleve dhe programeve i cili vlerëson dhe njeh kualifikimet e mëparshme bazuar në dokumentacion i cili përfshin planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve. Të gjitha llojet e transferimeve bëhen mbi bazën e kërkesës së studentit drejtuar institucionit. Komisioni i Vlerësimit pas shqyrtimit të kërkesës dhe dosjes së studentit ja paraqet Senatit, dosjen e studentit për miratim.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore</p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>Në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve shprehen mënyra e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor nga pedagogët e lëndëve përkatëse</p> <p>Skema e kontrollit të dijeve ndahet në vlerësimin e vazhdueshëm dhe provimin përfundimtar. Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet</p>

	<p>testimeve/provimeve me shkrim/me gojë/projekteve/ prezantimeve / praktikave.</p> <p>Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies dhe transparencën e vlerësimit. Ata përdorin dhe procedurat e rishikimit të vlerësimit. Sistem vlerësimi përdor sistemin shqiptar të vlerësimit me 10-të nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Nota minimale kaluese është 5 (pesë).</p> <p>Evidenca 46. Syllabus Msc. TEKNIK LABORATORI. Evidenca 6. Rregullore e Programit Msc. Teknik Laboratori.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e Institucionit dhe rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë mënyra e diplomimit. Koordinator i programit informon studentët për procedurat e diplomimit në fillim të ciklit akademik dhe në fillim të vitit të dytë bëhet zgjedhja e temës. Njësia kryesore ka përgatitur manualin përkatës të përpunimit të diplomës ku përcaktohen karakteristikat dhe struktura e tezës së diplomës. Në rregulloren e programit përcaktohen kushtet që duhet të përmbushë studenti për marrjen e diplomës dhe procedurën e diplomimit. Drejtuesit e temave të diplomës propozohet nga departamenti dhe miratohen nga rektori. Mbrotja e temës së diplomës bëhet në departamentit nga një juri e përbërë prej pesë veta. Vlerësimi i temës së diplomës bëhet me note bazuar në vlerësimin e udhëheqësit dhe punimin e studentit. GVJ konstatoi se emërtimi i diplomës përputhet me programin e studimit dhe objektivat formuese dhe karakterizuese të tij (diploma dhe suplementi i diplomës).</p> <p>Evidenca 11. Rregullore e Diplomimit te Studenteve. Evidenca 6. Rregullore e Programit Msc. Teknik Laboratori Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekësore</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Informimi i publikut për programet e studimit realizohet nga zyra e këshillimit të karrierës përmes fletëpalosjeve dhe organizimit të takime, shpërndarjen e posterave të të interesuarve si dhe spoteve publicitare në mediat lokale. Institucioni çdo vit përpara fillimit të vitit akademik harton kalendarin e takimeve me maturan të dhe prindërit e tyre për ti njohur me programet e studimit që ofron KUR. Gjithashtu organizohen takime me stafin mjekësor, studentët të vitit të fundit bachelor për ti informuar për programin e studimit Msc Teknik laboratorit.</p>



	Evidenca 107. Poster per informimin e maturanteve. Evidenca 67. Kalendari i Informimit te Maturantëve. Viti 2024. RBV			
Konkluzione	<p><i>Në rregulloren e departamentit, rregulloren e programit të studimit, dhe syllabuset, studenti gjen informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin dhe gjithashtu është përcaktuar shkalla e frekuentimit të detyruar për programin e studimit. Studentët kanë informacion për kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme.</i></p> <p><i>Procedurat e vlerësimit të dijeve janë të saktësuara në nenet e rregullores së programit të studimit dhe të detajuara në syllabuset e lëndëve. Institucioni ka përgatitur dhe një manual instruktues për përgatitjen e temës së diplomës.</i></p> <p><i>Informimi i publikut për programet e studimit realizohet përmes fletëpalosjeve, organizimit të takimeve informuese, sekretarisë mësimore, publicitetit në mediat lokale.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Studentët që ndjekin programin mësimor Master Shkencor në Teknikë Laboratori informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. Përmes Sekretarisë Mësimore dhe faqes ëeb ata gjejnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Informacion mbi institucionin që ofron programin e studimit – Informacion për objektivat formuese të programit – Strukturën dhe organizimin e programit – Planin mësimor – Syllabuset – Rregulloren – Suplementin e diplomës <p>Gjithashtu studentët njihen me keto informacione edhe gjatë javës së orientimit, javës pare të vitit akadmeik.</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Takimi me studentë dhe drejtues te FSHM</p> <p>GVJ konstaton se dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Në këtë dokumentacion studenti gjen informacion të detajuar për lëndët e modulet, organizimin dhe shpërndarjen e tyre në semestral, ECTS për secilën lëndë e modul, klasifikimin e lëndëve sipas tipit të veprimtarisë formuese. Në syllabuse studenti orientohet për tematikat dhe mënyrën e organizimit të orës së mësimit (leksion, seminar, praktikë). Informacioni jepet gjithashtu si në fillim të vitit ashtu dhe gjatë tij në varësi të kërkesave të studentëve edhe nga koordinatori i programit dhe pedagogët e lëndëve përkatëse.</p> <p>Evidenca 43. Program mesimor MSc. Teknik Laboratori. Evidenca 44. Plani mesimor - Msc. Teknik Laboratori - 2022-2023. Evidenca 46. Syllabus Msc. TEKNIK LABORATORI.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka lidhje të ngushta me operatorët mjekësore dhe me Urdhërin e Infermierit, ku marrin informacion për vendet e lira të punës. Një rol të rëndësishëm në këtë proces luan Zyra e Këshillimit të Karrierës. Marrëveshjet e bashkëpunimit që ka institucioni me institucionet shëndetësore publike dhe private ka ndihmuar në punësimin e studenteve pas diplomimit dhe marrjes së licencës së ushtrimit të profesionit. Zyra e këshillimit të karrierës me zyrën ALUMIN kanë të dhëna për punësimin e studentëve të diplomuar në KUR, sipas të cilës të gjithë studentët e diplomuar janë punësuar. Ky program studimi akoma nuk ka të diplomuar duke qenë se është një program i hapur rishtazi.</p> <p>Evidenca 78. Te dhena per punesimimin e studenteve 2017 - 2023. Takimi me stafin drejtues</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët eidenton që ata informohen hollësisht dhe gjëresisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, aktivitetet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse. Në vende të dukshme shpallet orari mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në Teknikë Laboratori, në të cilin janë të pasqyruara të gjitha të dhënat në lidhje me procesin mësimor (leksione, seminare, klasat, pedagogët përgjegjës, etj.), këto të dhëna iu dërgohen dhe në formë elektronike studentëve nga koordinatori i programit të studimit.</p>



	Praktika profesionale ofrohet sipas marrëveshjeve, në spitalet, klinika mjekësore, laboratore dhe institucionet e tjera të shërbimit shëndetësor. Në funksion të studentëve është dhe biblioteka dhe shërbimet e sekretarisë.			
	Takime me studentet dhe me drejtuesit.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	KUR ka një sistem elektronik të brendshëm përmes të cilit mundësohet informimi studentit për programin e studimit. Studenti disponon një kod personal përmes të cilit mund të aksesojë të dhënat e tij në çdo moment. Veç detajeve për programin e studimit dhe detajeve individuale për notat etj. Informacioni i detajuar dhe i rifreskuar ndodhet gjithashtu edhe në faqen web të Instucionit. Faqja web, Takim me Studentet.			
Konkluzione	<i>Studentët që ndjekin programin mësimor informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. GVJ konstaton se dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidenton që ata informohen hollësisht dhe gjërësisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitetet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Në sekretarinë mësimore të FSHM janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për çdo program studimi. Sekretaria për këtë program studimi ka: <ul style="list-style-type: none"> – Regjistrin themeltar të studentëve; – Regjistrin me të dhënat akademike (regjistri i notave). Në takimin me sekretarinë mësimore u informuam se regjistrat në formë të shkruar depozitohen me kohë të pacaktuar dhe arkivohen

	<p>në arkivën e shtetit. Gjithashtu Institucioni përpunon të dhëna në lidhje me cilësinë në hyrje dhe dalje të studenteve dhe disponon të dhëna të dhëna në lidhje me punësimin pas diplomimit.</p> <p>Vizita në sekretarinë mësimore.</p> <p>Evidenca 60. Numri i studenteve të regjistruar në 2 vitet e fundit për çdo program studimi MSc. Teknik Laboratori</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjen nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit. Në sekretari depozitohen dosjet e studentëve të plotësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi, listat e frekuentuesve si dhe një numër dokumentacionesh për procedurat e transferimit dhe të çregjistrimit. Këto të dhëna ruhen edhe në sistemin elektronik dhe menaxhohen nga sekretaria mësimore.</p> <p>Për këtë program studimi, të dhënat në lidhje me regjistrimin janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viti akademik 2022-2023, 7 Studentë; - Viti akademik 2023-2024, 5 Studentë. <p>Evidenca 61. Lista e studenteve të regjistruar në MSc. Teknik Laboratori.</p> <p>Evidenca 60. Numri i studenteve të regjistruar në 2 vitet e fundit për çdo program studimi MSc. Teknik Laboratori</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Për menaxhimin e të dhënave statistikore të studentëve, GVJ në takimin me punonjësit e sekretarisë mësimore inspektoi hapësirat e punës dhe arkivimit të dokumentacionit dhe u njoh me një numër dokumentesh si dosja e studentit, regjistrat. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm elektronik të informacionit dhe në hardcopy, në kushte të sigurisë së lartë, në të cilin kanë akses personat e autorizuar në varësi të detyrës (sekretaria, dega mesimore, tutoriati akademik, IT etj). Këto të dhëna janë të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e autorizuar të të dhënave, informacioni personal i studentëve ruhet në mënyrë konfidenciale dhe shpërndahet vetëm për palët e autorizuara në plotësim të kriterëve që përcaktohen në ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale" si dhe në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore për Arsimin e Lartë si dhe në bazë të Rregulloreve të funksionimit të KUR.</p>

	<p>Evidenca 63. Regjistri i notave te studenteve Msc. Teknik Laboratori.</p> <p>65. Të dhëna për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Evidenca 104. Database per ruajtjen e te dhenave dhe dokumentave te studenteve ne rruge elektronike- ne gjuhe te huaj.</p> <p>Evidenca 103. Database per ruajtjen e te dhenave dhe dokumentave te studenteve ne rruge elektronike.</p> <p>Evidenca 14. Rregullore e standardizimit te procedurave per ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve - 2020.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>KUR ka përpiluar mekanizma ku ndërmjet dhe drejtorive përkatëse që lidhen me organizimin e punës kryejnë kontrole periodike (auditim të brendshëm) pranë sekretarive mësimore dhe departamenteve ku bëhet vlerësimi i dokumentimit dhe menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit të ruajtur dhe sistemuar.</p> <p>Evidenca 72. Raport vjetor i sigurimit te cilesise- NJSBC - 2023-2024.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Raportet analitike përpilohen nga departamenti në bashkëpunim me Zyrën e karrierës në formën e analizës vjetore. Në këto raporte ka të dhëna kryesisht për cilësinë në hyrje e dalje të studentëve. Ka të dhëna në lidhje me kalueshmërinë, frekuentimin, diplomimin. Zyra Alumni gjithashtu harton në menyre periodike raporte lidhur me punësimin e të diplomuarve. Gjatë takimeve u deklarua që të gjithë studentët e diplomuar në programin Teknik laborator janë të punësuar.</p> <p>Evidenca 72. Raport vjetor i sigurimit te cilesise- NJSBC - 2023-2024.</p> <p>Evidenca 65. Të dhëna për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në sekretarinë mësimore të FSHM janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për çdo program studimi.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit.</i></p>

	<i>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm. IAL përpilon raporte në formën e analizës vjetore të cilët përfshijnë të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimin dhe diplomimin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e institucionit, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të KUR. Në RVB theksohet se studentët janë të përfaqësuar në Senatin e KUR me senator të zgjedhur nga vetë studentët.</p> <p>Studentet janë pjesëmarrës në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senatin akademik; • NJSBC; • Komisioni e kurrikulave; • Komisionin e kërkimit shkencor • Në GVB për akreditimin e programeve të studimit. <p>Në KUR funksion dhe këshilli studentor i cili promovon pjesëmarrjen e studentëve në organet drejtuese të KUR, strukturat kërkimore shkencore.</p> <p>Evidenca 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD. Evidenca 75. Urdher i Dekanit për ngritjen e GBV për programin MSc. Teknik Laboratori.pdf</p>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me	<p>Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e zgjedhura, gjithashtu dhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Në takimin me studentët, GVJ konstaton se studentët plotësojnë pyetësorë në mënyrë periodike, përfshihen në punë studimore dhe aktivitete promovionale e trajnuese të organizuara nga FSHM.</p>

rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët shprehen të kënaqur për përfshirjen e tyre dhe angazhimin për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e procesit akademik. Takim me Studentët.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Për tërheqjen e mendimit të studentëve në funksion të përmirësimit të programeve të studimit, institucioni përdor një seri mekanizmesh. Këshilli studentor, i cili funksion në bazë të një rregullore, është organizmi ku studentët debatojnë dhe problematikat e trajtuara i adresojnë në forumet drejtuese të FSHM për zgjidhje. Koordinator i programit është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar problemet që dalin në kohë reale. Koordinator kujdeset për përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit të kurrikulës. GVJ vlerëson se ky është një program i ri dhe ende nuk i është nënshtruar ndryshimeve të kurrikulës, që mund të zhvillohen pas akreditimit të parë. Evidenca 9. Rregullore e NJSBC
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatet e provimeve, me zgjidhjen e tezës pas provimit dhe të ndjekin shkallët e ankimimit për rivlerësim. Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Në takim me GVJ, studentët shprehen të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve dhe me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikim të tezës së provimit. Departamenti pas procesit të ankimimit ngrejnë komision rivlerësimi, i cili bën rishqyrtim dhe rivlerësim të provimit. Evidenca 10. Rregullore për Zhvillimin e Provimeve - 2018. Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore - E ndryshuar.pdf
Konkluzione	<i>Studentët janë pjesëmarrës në: Senatin akademik, NJSBC, Komisionin e kurrikulave, Komisionin e kërkimit shkencor, në GVB për akreditimin e programeve të studimit.</i> <i>Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet edhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Në takimin me studentët ata vlerësuan pozitivisht cilësinë e</i>

	<p><i>mësimdhënies. Në rregulloren e FSHM dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Koordinator i programit është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar problemet që dalin në kohë reale. GVJ evidenton që nuk ka ndryshime të kurrikulës pasi ky program është një program i ri.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>FSHM ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL. Studentet informohen nga faqja e web-it të KUR e cila përditësohet vazhdimisht.</p> <p>Gjithashtu në funksion të informimit të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI. - Sekretaria mësimore; është e hapur cdo ditë për studentët dhe ofron shërbim akademik nga regjistrimi në diplomim. <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës realizon informimin e studenteve dhe të gjitha shërbimet që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim. Gjithashtu, KUR ka ngritur dhe ka funksional sistemin e komunikimit elektronik midis studentëve dhe stafit akademik. Sistemi mbështet studentët gjatë gjithë periudhës së tyre akademike si në proceset akademike në auditor ashtu edhe gjatë praktikave profesionale.</p> <p>Evidenca 9. Rregullore e NJSBC. Evidenca 4. Rregullore e Pergjithshme KUR - 2018.</p>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të	Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve i përshkruar në Kriterin 1 është funksional dhe i përshtatshëm. Studentët u shprehën të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në

<p>studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>aspekte të procesit mësimor, për pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, promovuese dhe trajnuese bashkë me pedagogët.</p> <p>Takimi me studentë.</p> <p>Evidenca 4. Rregullore e Përgjithshme KUR - 2018.</p> <p>Evidenca 52. Rregullore e zyrës së këshillimit dh e karrierës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>FSHM u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Pranë institucionit funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës ku studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme. Zyra e këshillimit të karrierës i ndihmon studentët për:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Identifikimin e lidhjeve midis diplomës që do të marrin dhe mundësive për karrierë; – Identifikimin e burimeve për pozicione të veçanta pune; – Zhvillimin e strategjive për mënyrën e të kërkuarit të punës; – Identifikimin e aftësive dhe shprehive; – Udhëheqje akademike; – Identifikimin e shprehive dhe aftësive; – Përcaktimin e objektivave të karrierës. – Organizimin e aktiviteteve midis studentëve të programeve të ndryshme – Mbështetje të studentëve me bursa studimi <p>Në këtë zyrë studentët gjejnë mbështetje për përgatitje për intervista pune, shkrimin e CV dhe letrave të motivimit etj.</p> <p>Evidenca 52. Rregullore e zyrës së këshillimit dh e karrierës.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Në takimin e GVJ me Zyrën e Këshillimit të Karrierës u informuam se kjo zyre asiston në gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ky program ende nuk ka diplomuar studentët e parë dhe GVJ nuk mund të vlerësojë gjurmimin e tyre. Në rregulloren e funksionimit të Zyrës së Këshillimit të Karrierës theksohet se ajo ka detyrë të mbajë lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një databazë të të dhënave të cilat përditësohen çdo vit. Këto të dhëna gjurmimi të studentëve pas përfundimit të studimeve u vihet në dispozicion edhe departamenteve, duke i ndihmuar ata të kenë kontakte të vazhdueshme midis studentëve të diplomuar dhe FSHM-së.</p> <p>Evidenca 52. Rregullore e zyrës së këshillimit dh e karrierës</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>FSHM ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL. Në institucion funksionon Zyra e Këshillimit të</i></p>

	<i>Karrierës dhe Alumni. Studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme pranë kësaj zyre. Kjo zyrë mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një databazë të të dhënave të cilat përditësohen çdo vit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Implementimi dhe përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies më qëllim rritjen e cilësisë akademike është një proces i rëndësishëm në përmirësimin e performancës së institucioneve të arsimit të lartë. Gjatë bisedës me drejtues dhe RVB evidentohet që institucioni nxit stafin akademik për implementimin e metodave të reja të mësimdhënies. Për këtë qëllim institucioni ka përgatitur dhe udhëzues të vecantë për përdorimin e metodave të mësimdhënies si përdorimi i teknologjisë për zhvillimin e procesit mësimor në klasë apo online, për procedura e regjistrimit me video apo me audio. Evidenca 17. Manual për programin OBS për regjistrim video dhe audio. Evidenca 16. Google Classroom - Manual për studentet. Evidenca 18. Google Classroom - Manual për pedagogët. Evidenca 4. Rregullore e Përgjithshme KUR - 2018.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë	Institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron e vlerëson përmes njësive të posaçme periodikisht programet e studimit. Institucioni ka ngritur Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. IAL Bazuar në Statusin dhe

<p>periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Rregulloren e NJSBC me vendim të Senatit Akademik është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit. Kjo njësi është në nivel institucionl dhe përbëhet nga pesë anëtarë ku 3 persona janë personel akademik të njësive kryesore (kordinatorë pranë cdo fakulteti), një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues nga këshilli studentor.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zhvillon në fund të çdo semestri pyetësorët studentëve për matjen e performancës dhe cilësinë e mësimdhënies, kryen anketime me studentët, monitoron zhvillimin e procesit mësimor dhe në fund të vitit harton raportin për aktivitetin vjetor, rezultat, konkluzione dhe rekomandimet përkarëse dhe japaraqet rektorit të KUR.</p> <p>Nga takimi me stafin e Zyrës së Këshillimit të Karierrës (ZKK) dhe NJSBC u theksua se këto dy zyra mbulohen nga i njëti person. Bazuar në ngarkesën e punës pasi pedagogu ka dhe ngarkesë mësimore, numrin e lartët studentëve rreth 800 studentë <i>GVJ rekomandom titullarit të FSHM të emëroj staf tjetër për ZKK e cila mund të përbëhet nga dy anëtarë njëri për studentët shqipatrë (500 studentë) dhe një tjetër për studentët e huaj. GVJ pas shqyrtimit edhe të rregullores rekomandon përditësimin dhe rishikimin e rregullores së NJSBC, me qëllim përcaktimin më të qartë të fushave të veprimtarisë.</i></p> <p>Evidenca 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD. Evidenca 9. Rregullore NJSBC. Evidenca 69. Struktura e NJSBC.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Bazuar në statutin e institucionit, studentëve u sanksionohet e drejta për të qenë pjesë aktive e NJSBC, si edhe komisioneve të tjerë në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti. Studentët janë pjesë aktive e vlerësimeve periodike të procesit të mësimdhënies. Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, dy herë në vit plotësojnë pyetësorët për vlerësimin e metodave të mësimdhënies.</p> <p>Studentët janë në fokusin kryesor të Strategjisë së zhvillimit institucional dhe kontribuojnë në mënyrë direkte në vlerësimin si të institucionit në përgjithësi ashtu edhe të programeve apo lëndëve specifike. Përfaqësues të studentëve janë pjesë e grupeve të punës në nivel institucional; përfshirë departamentin, dekanatin dhe rektoratin e institucionit.</p> <p>Evidenca 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD,</p>

	<p>Evidenca 9. Rregullore NJSBC. 69. Struktura e NJSBC. Evidence 74. Pyetësi i studentëve.</p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Siç u theksua dhe më lart pranë KUR funksionon Njësia e Sigurimit të Cilësisë, e cila në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësin e studentëve për matjen e performancës. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, kjo strukturë organizon pyetësin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, pyetësin për kushtet në IAL (infrastruktura, biblioteka, laboratorët, mbështetj me bursë etj). Të dhënat publikohen periodikisht me qëllim rritjen e transparencës ndaj të gjithë aktorëve të përfshirë, institucioni përpilon raportin në përmbyllje të çdo viti akademik, i cili publikohet në faqen zyrtare të universitetit. Në RVB dhe në takimet me përfaqësues të zyrës u deklarua se për problematikat e shfaqura bëhet adresimi dhe diskutohen hapësirat e përmirësimit.</p> <p>Evidenca 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD. Evidenca 9. Rregullore NJSBC. 69. Struktura e NJSBC. Evidence 74. Pyetësi i studentëve. 73. Pyetësori i NJSBC për kushtet në IAL.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në RVB dhe gjatë takimeve me përfaqësues të institucionit u deklarua se Institucioni, bazuar në strategjinë e tij, informon në mënyrë të rregullt personelin akademik për proceset e vlerësimit të cilësisë duke e nxitur atë në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies.</p> <p>Evidenca 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD Evidenca 9. Rregullore NJSBC.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron e vlerëson përmes njësive të posaçme periodikisht programet e studimit. Nga RVB dhe gjatë takimeve me përfaqësues të institucionit u deklarua se Institucioni, bazuar në strategjinë e tij, informon në mënyrë të rregullt personelin akademik për proceset e vlerësimit të cilësisë duke e nxitur atë në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies. GVJ pas shqyrtimit të rregullores rekomandon përditësimin dhe rishikimin e rregullores së NJSBC, me qëllim përcaktimin më të qartë të fushave të veprimtarisë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në Nenin 103 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë: “Institucionet e Arsimit të Lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë”. Struktura dhe funksionimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) përcaktohen në Statutin e Institucionit të Arsimit të Lartë. Institucioni ka të sanksionuar në Statutin e vet përgjegjësitë institucionale për sigurimin e cilësisë. Këto politika përcaktohen në Statutin e IAL, rregulloren e UA, Rregulloren e Njësisë së Vlerësimit të Cilësisë, dhe janë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore. Konkretisht NJSBC e bazon aktivitetin e saj në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015; - Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë (VKM 531/11.09.2018); - Statuti i institucionit; - Vendimet e senatit, urdhërat e brendshëm, plani i punës. <p>Evidenca 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD Evidenca 9. Rregullore NJSBC.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka ngritur dhe ka funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. IAL, me vendim të Senatit Akademik ka ngritur NJSBC e cila funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit. Kjo njësi funksionon në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Kurrikulave dhe këshillimit të karrierës dhe departamentet. Njësia ka rregulloren mbi të cilën bazon aktivitetin e saj dhe vlerëson në mënyrë periodike aktivitetin mësimor dhe kërkimor shkencor të institucionit. Në përbërje të NJSBC janë 3 anëtarë personel akademik, ku përfshihen përfaqësues të fakulteteve dhe një ekspert i jashtëm, gjithashtu në përbërje të NJSBC është dhe një përfaqësues të studentëve.</p> <p>NJSBC e bazon veprimtarinë e saj në dokumenta konkrete dhe</p>



	<p>përpilon një plan kalendarik veprimi. Për të realizuar planin e saj ajo bashkëpunon ngushtësisht me të gjitha strukturat akademike dhe administrative të institucionit dhe ka akses në gjithë dokumentacion akademik dhe administrativ, duke ruajtur anonimat dhe konfidencialitetin.</p> <p>NJSBC ka detyrim institucional hartimin e raporteve. NJSBC funksionon me plan pune vjetor dhe ushtron një seri aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcakton pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë në disa nivele. Bashkërendon gjithashtu procesin ndërmjet njësive në nivel institucional; - Monitoron procesin, mbledh informacione, evidenton problematikat, ofron udhëzime dhe rekomandime në jesisë bazë; - Administron dokumentacione, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm. - Bashkëpunon me NJSBC apo organizma të tjera të sigurimit të cilësisë të IAL-ve homologe me qëllim shkëmbim e përvojës për garantimin dhe rritjen e cilësisë në arsimin e lartë. <p>Evidenca 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD. Evidenca 9. Rregullore NJSBC. Evidence 71. Plan pune i NJSBC. Viti akademik 2023-2024. Takim me përfaqësues të zyrës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka dhe përdor instrumenta për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. KUR i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues institucional gjithashtu dhe të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Njësia e sigurimit të brendshëm deklaron se bën vlerësim periodik të veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të Universitetit dhe harton Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm të cilat diskutohen në të gjitha njësitë e IAL.</p> <p>Mënyra kryesore e vlerësimit realizohet më anë të pyetësorëve të studentëve në lidhje me vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve administrative.</p> <p>Në përmbushjen e këtyre qëllimeve një rol të rëndësishëm kanë departamentet e FSHM ku koordinatori i programeve realizon funksione specifike në lidhje me rishikimin dhe përmirësimin e</p>

	<p>programeve të studimit duke u bazuar gjithmonë në parashikimet ligjore dhe në strategjinë e sigurimit të cilësisë së IAL. Raportet vevlerësuese shërbejnë institucionit për tu përgatitur për procesin e akreditimit.</p> <p>Evidenca 4. Rregullore e Përgjithshme KUR - 2018. Evidenca 9. Rregullore NJSBC. Evidenca 77. Raport i departamentit për vlerësimin e programit të studimit Msc. Teknik Laboratori.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Metodat që përdor NJSBC janë: pyetësorët për studentët, inspektime gjatë zhvillimit të mësimin, leksione të hapura, intervista, vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës, pyetësorët e vlerësimit të anëtarëve të stafit akademik, vevlerësimit të pedagogëve, anketime me student dhe pedagogë.</p> <p>NJSBC përpiket për monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, për të cilat GVJ, inkurajon konsolidimin si procese permanente që kryhen si në nivel institucional dhe gjithashtu në nivel programi studimi duke realizuar vlerësime analitike e krahasuese, si dhe procese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p> <p>Evidenca 77. Raport i departamentit për vlerësimin e programit të studimit Msc. Teknik Laboratori.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>NJSBC e bazon veprimtarinë e saj në dokumenta konkrete dhe përpilon një plan kalendarik veprimi. Për të realizuar planin e saj ajo bashkëpunon ngushtësisht me të gjitha strukturat akademike dhe administrative të institucionit dhe ka akses në gjithë dokumentacion akademik dhe administrativ, duke ruajtur anonimat dhe konfidencialitetin. NJSBC përpiket për monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, për të cilat GVJ, inkurajon konsolidimin e mëtejshëm si procese permanente që kryhen si në nivel institucional dhe gjithashtu në nivel programi studimi duke realizuar vlerësime analitike e krahasuese, si dhe procese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>KUR përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas hershme të programit të studimit. Disa nga instrumentat e përdorur janë pyetësorët e studentëve për procesin e mësimdhënies, si dhe analizat periodike të punës në nivel departamenti, intervistat me student, ndjekje të procesit mësimor etj.</p> <p>Vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të ndryshme, me qëllim përmirësimin e mësimdhënies së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standardeve akademike.</p> <p>Disa nga instrumentat e vetëvlerësimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Analiza vjetore e departamentit; – Vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik; – Pyetësi i studentëve për cilësinë e programit mësimor e mësimdhënien. – Intervistat me student dhe pedagogw <p>Të gjitha gjetjet e këtyre vlerësimeve janë pjesë e raportit vjetor të NJSBC i cili i vihet në dispozicion rektoratit.</p> <p>Në përmbushjen e këtyre qëllimeve, bazuar në RVB dhe gjatë diskutimeve me drejtuesit, një rol të rëndësishëm kanë departamentet e FSHM ku koordinatori i programeve realizon funksione specifike në lidhje me rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit duke u bazuar gjithmonë në parashikimet ligjore dhe në strategjinë e sigurimit të cilësisë së IAL.</p> <p>Evidenca 9. Rregullore NJSBC. Evidenca 21.1.1 Raport NJSBC.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të</p>	<p>NJSBC vlerëson efikasitetin e veprimtarive akademike, administrative dhe financiare të KUR dhe harton raportin përkatës të Vlerësimit të Brendshëm. Raportet e vlerësimit diskutohen në të gjitha njësitë e KUR, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen.</p> <p>NJSBC ka realizuar një analizë vjetore të këtij programi studimi të përfshirë në raportin e përgjithshëm të IAL-së, ku ka informacione në lidhje me vlerësimin e studentëve për personelin e angazhuar në program, perceptimin e tyre në lidhje me aspektet e</p>

<p>cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>mësimdhënies, aspektet administrative, këshillimit të karrierës, asistencës institucionale etj.</p> <p>Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, GVJ identifikoi rezultate të proceseve të anketimit të studentëve. Këto rezultate janë paraqitur në Raportin vjetor të institucionit dhe në raportin vjetor të NJSBC.</p> <p>Evidenca 72. Raport vjetor i sigurimit te cilesise- NJSBC - 2023-2024.</p>
<p>Kriteri 3.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Bazuar në dokumentat e KUR dhe nga informacioni i marrë, rezultojnë se NJSBC bën vlerësim institucional dhe harton raporte për të gjithë programet e studimit. GVJ evidenton se analiza vjetore e programit e përfshirë në raportin e përgjithshëm ka të dhëna sasore dhe bën një analizë të hollësishme por adresimi dhe zgjidhja e problematikave duhet pasqyruar më mirë.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit NJSBC përdor metoda dhe instrumente të ndryshme për mbledhjen e informacionit siç janë: intervistat e strukturuar, intervistat joformale, takimet e drejtpërdrejta me studentë të programit. Gjithashtu institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta siç janë: Monitorimi i mësimdhënies, vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësimi i kurrikulës, monitorimi i provimeve, dëgjime në auditor, vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve, praktikës etj, [takimi me stafin, drejtuesit].</p> <p>Institucioni, gjithashtu përdor dhe instrumenta të tërthorta vlerësimi siç janë: sondazhe të studentëve, të personelit akademik, ndihmës akademik apo të institucioneve të cilat bashkëpunojnë për programin e studimit, intervista etj. Rezultatet e këtyre vlerësimeve raportohen tek drejtuesit e departamente dhe dekanëve, duke u bërë pjesë e vlerësimit të performancës të çdo pedagogu në fund të vitit akademik.</p>
<p>Kriteri 4.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e</p>	<p>Një vend të rëndësishëm në këtë vlerësim gjithashtu zë edhe informacioni i përpunuar nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumni, përmes kësaj zyre realizohet “gjurmimi” i studentëve që kanë përfunduar më parë këto programe studimi për evidentimin e pozicioneve të punësimit apo kualifikimet e mëtejshme pas përfundimit të programit të studimit. Takimet me këta studentë japin informacion në lidhje me problemet që mund të përmirësohen me qëllim rritjen e kompetencave profesionale për të përballuar sa më mirë tregun e sfidat e profesionit. Në rastin e këtij programi</p>

<p>administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>studimi ende nuk ka studentë alumni pasi ai akreditohet për herë të parë.</p> <p>Të dhënat e drejtpërdrejta apo të tërthorta që tërheq dhe përpunon NJSBC shërbejnë për të evidentuar treguesit problemikë të cilësisë me qëllim adresimin dhe zgjidhjen e tyre.</p> <p>Theksojmë që aktorët e jashtëm japin një kontribut mjaft pozitiv në realizimin e praktikave mësimore e profesionale, nënvizojmë që kontributi i tyre konkret në vlerësimin e realizimit dhe cilësisë së programit të studimit në funksion të përmirësimit të cilësisë së tij të rritet më tej.</p> <p>Evidenca 72 Raporti NJSBC. Evidenca 74. Model pyetësori për studentët. Evidenca 76. Pyetësor për performancën e mesimdhënien. Evidenca 66. Model vlerësimi nga pedagogu për stafin akademik.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KUR përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas hershme të programit të studimit. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta dhe të drejtpërdrejta vlerësimi. NJSBC ka realizuar një analizë vjetore të këtij programi studimi të përfshirë në raportin e përgjithshëm të IAL-së, ku ka informacione në lidhje me vlerësimin e studentëve për personelin e angazhuar në program, perceptimin e tyre në lidhje me aspektet e mesimdhënies, aspektet administrative, këshillimit të karrierës, asistencës institucionale etj. Aktorët e jashtëm japin një kontribut mjaft pozitiv në realizimin e praktikave mësimore e profesionale, GVJ rekomandon që kontributi i tyre konkret në vlerësimin e realizimit dhe cilësisë së programit të studimit në funksion të përmirësimit të cilësisë së tij të rritet më tej.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në statutin, rregulloren dhe planin strategjik të KUR përshkruhet përbërja e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit në përbërje të këtij komisioni janë 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 3 (tre) janë anëtarë nga personeli akademik i KUR, nga një përfaqësues për çdo fakultet, 1 (një) ekspert i jashtëm dhe 1 (një) student.</p> <p>Prania e studentëve si anëtarë të komisionit krijon mundësinë e bashkëveprimit me studentët për të përfituar ndjesinë e tyre dhe për të bërë efektiv kontributin e tyre në sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Evidenca 9 rregullore NJSBC. Evidenca 4. Rregullore e Përgjithshme KUR.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u takua me aktorë të rëndësishëm të jetës akademike, Dekanin e FSHM, Përgjegjës të Departamentit, Përfaqësues të Stafit Akademik, me Grupin e Vetëvlerësimit me përfaqësues të NJSBC dhe Zyrës së Karrierës, etj. Në këto takime doli në pah organizimi i mirë i punës së përditshme, koordinimi dhe angazhimi optimal në procesin e akreditimit, motivimi, përgjegjësia dhe entuziazmi për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë.</p> <p>GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces janë të bashkuar dhe koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. Studentët u shprehën entuziastë për programin e studimit. Ata referuan se janë të përfshirë në vetëvlerësim përmes pyetsorëve, propozimeve të këshillit studentor si dhe përmes përfaqësuesve të tyre në GVB.</p> <p>Evidenca 9 Rregullore NJSBC. Takime me stafin, studentët, përfaqësues të zyrave.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e</p>	<p>NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë. GVJ evidenton që të gjitha proceset dhe aktivitetet në lidhje me sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë janë organizuar të centralizuara në nivel institucional, me qëllim përmirësimin dhe thellimin e këtij procesi.</p>

administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Evidenca 9 Rregullore NJSBC.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është respektuar liria dhe etika akademike si dhe kuadri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetsori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studentëve. Evidenca 9 Rregullore NJSBC. Evidenca 72. Raport vjetor i sigurimit te cilesise- NJSBC - 2023-2024.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në procesin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit institucioni ka përfshirë ekspertë të jashtëm, që ndihmon në përgatitje e pyetesore dhe përgatitjen e raporteve të NJSBC, proces të cilin GVJ e vlerëson. Në procesin e vlerësimit institucioni deklaron se realizon takime me ish të diplomuar, mjekë specialiste, eksperte të mjekësisë laboratorike të cilët japin mendime të vlefshme në lidhje me përmirësimin e programit të studimit dhe lidhjen më efektive me kërkesat e tregut të punës. GVJ inkurajon përfshirje e ekspertëve të jashtëm në ndihmë të NJSBC, por ky kontribut nuk është i dokumentuar. Rekomandojmë që këto takime të formalizohen dhe të dokumentohen në të ardhmen. Evidenca 9 Rregullore NJSBC. Takimi me Njesisne e SBC. Evidenca 69 Struktura e NJSBC.
Konkluzione	<i>Në statutin, rregulloren dhe planin strategjik të KUR përshkruhet përbërja e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit, në përbërje të të cilit janë 5 (pesë) anëtarë, tre anëtarë staf me kohë të plotë në KUR, një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues i studentëve. GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin të bashkuar dhe koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre.</i>



	<i>GVJ evidenton që të gjitha proceset dhe aktivitetet në lidhje me sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë janë organizuar të centralizuara në nivel institucional, me qëllim përmirësimin dhe thellimin e këtij procesi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit. Statuti, Rregulloret, vendime të senatit etj gjenden të publikuara në këtë faqe të hapur për publikun e interesuar. Informacionet përcillen dhe në formë shkresore në njësinë kryesore dhe njësitë bazë ku janë të aksesueshme nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët. <i>Gjithsesi, GVJ rekomandon që përditësimin dhe rishikimin e rregullores së NJSBC, me qëllim përcaktimin më të qartë të fushave të veprimtarisë.</i></p> <p>Evidenca 9 Rregullore NJSBC. Statuti Faqja web</p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>NJSBCB realizon pyetësorët institucional në fund të cdo semestri, të cilët publikohen rregullisht duke rritur transparencën. Në hartimin e raportit NJSBCC respekton lirinë akademike dhe kodin e etikës si dhe kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Raporti i monitorimit u komunikohen strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studenteve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individeve. Institucioni publikon raportin e vetëvlerësimit të brendshëm në faqen e web tw KUR për të gjithë aktorët që kanë lidhje me universitetin dhe publikun e interesuar.</p> <p>Evidenca 9. Rregullore NJSBC.</p>

	<p>Evidenca 72. Raport vjetor i sigurimit te cilesise- NJSBC - 2023-2024.</p> <p>Faqja web.</p> <p>Takime me përfaqshues të zyrës.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të brendshëm, raportohen prane rektoratit dhe dekanateve te fakulteteve. Në analizën e saj NJSBC-ja informon njësitë bazë dhe ato kryesore me rezultatet e vlerësimit të brendshëm, pikat e forta dhe dobësite e tyre.</p> <p>Raporti i monitorimit u komunikohen strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studenteve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individëve.</p> <p>Raporti i NJSBC shoqërohet me adresim të problematikave dhe rekomandimet përkatëse të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. GVJ vlerëson që NJSBC pas konstatimit të problematikave dhe rekomandimeve përkatëse harton planin e punës për implementimin e tyre dhe ja parqet senatit akademik dhe Bordit te Administrimit për miratim.</p> <p>Evidenca 9. Rregullore NJSBC.</p> <p>Evidenca 72. Raport vjetor i sigurimit te cilesise- NJSBC - 2023-2024.</p> <p>Faqja web.</p> <p>Takime me përfaqshues të zyrës.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga takimet e realizuara në Institucion GVJ vlerëson se aktorët pjesëmarrës në proceset e vlerësimit si NJSBC, zyra e zhvillimit të karrierës luajnë rol kryesor në ndërgjegjësimin, informimin e personelit akademik, studentëve në lidhje rëndësinë dhe përmirësimin e proceseve të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Takimi me stafin drejtues, stafin akademik, NJSBC</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin</p>	<p>GVJ vlerëson së aktorët pjesëmarrës në proceset e vlerësimit si NJSBC, zyra e zhvillimit të karrierës luajnë rol kryesor në ndërgjegjësimin, informimin e personelit akademik, studentëve në lidhje me rëndësinë dhe përmirësimin e proceseve të sigurimit të cilësisë.</p>



afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Evidenca 71. Plan pune i NJSBC. Viti akademik 2023-2024. Evidenca 90. Plan Pune per kualifikimin e stafit akademik ne fushen kerkimore-shkenore. Viti akademik 2023-2024. Evidenca 114. Professional Qualifications Directive, 2005-36-EU.			
Konkluzione	<p><i>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit. NJSCB realizon pyetësorët institucional në fund të çdo semestri, të cilët publikohen rregullisht duke rritur transparencën.</i></p> <p><i>Raporti i monitorimit u komunikohet strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studentëve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individëve. Raporti i NJSBC shoqërohet me adresim të problematikave dhe rekomandimet përkatëse të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</i></p> <p><i>GVJ vlerëson së aktorët pjesëmarrës në proceset e vlerësimit si NJSBC, zyra e zhvillimit të karrierës luajnë rol kryesor në ndërgjegjësimin, informimin e personelit akademik, studentëve në lidhje me rëndësinë dhe përmirësimin e proceseve të sigurimit të cilësisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Teknik laborator” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar REALD

Pika të forta dhe afirmimet:

1. Institucioni ka qëndrueshmëri financiare, kapacitetet dhe logjistike të mjaftueshme, për të pritur një numër më të madh studentësh në këtë program studimi.
2. Bashkëpunim i institucional dhe i këtij programi studimi me institucionet shëndetësore dhe laboratore mjekësore për zhvillimin e praktikave profesionale dhe hulumtimeve shkencore që kryejnë studentët gjatë zhvillimit të temave të diplomave
3. Mbështetja financiare e stafit akademik në aktivitetin kërkimor shkencor duke i përfshirë në projekte shkencore që kontribuojnë në formimin profesional dhe shkencor.
4. Përfshirjen e studenteve në proceset vendimarrëse të institucionit për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies si motivimin e tyre nëpërmjet përfshirjes në projekte që ka IAL.

Pika të dobta:

1. Mungesa e laboratorëve mjekësorë mësimor Biokimik Klinik, Mikrobiologjik apo Histologjisë për zhvillimin e praktikës mësimore. *(IV.2, kriteri 3)*
2. Mungesa titullarëve të lëndëve nga kategoria profesor në disa lëndë si dhe angazhimi i stafit akademik me Msc. në këtë program studimi. *(II.3, kriteri2)*
3. Formimi profesional i disave nga stafi akademik nuk përputhet me lëndët që ata realizojnë në këtë program studimi. *(IV.1, kriteri 1)*

Rekomandime:

1. GVJ rekomandon rekrutimin e stafit akademik me formim mjekësor në përputhje me lëndët që do të zhvillojnë në programin mësimor, mos angazhimin e stafit akademik me Msc. në këtë program studimi si dhe rishikimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik (duke qenë se PAE mbulon 60% të ngarkesës totale).
2. Sugjerohet që titullarët e lëndëve të përzgjidhen nga kategoria profesor dhe të plotësohet kriteri ligjor.
3. Rekomandojmë ngritjen e laboratorëve mjekësorë mësimor Biokimik Klinik, Mikrobiologjik apo Histologjisë për zhvillimin e praktikës mësimore në ambientet e IAL-së.
4. Rishikimin e sylabuseve të imunologjisë, mjekësisë transfusive, organizimim, menaxhim dhe promovim shëndeti, si dhe përditësimin e literaturës së sylabuseve me qëllim përmirësimin e programit të studimit (duke qenë se në disa raste është e vjetër dhe jo bashkohore).
5. GVJ sugjeron të rishikohen marrëveshjet me institucionet shëndetësore që ju ka mbaruar afati i bashkëpunimit.

6. Rekomandohet të shtohet numri i stafit në Zyrën e Këshillimit të Karrierës, e cila mund të përbëhet nga dy anëtarë, njëri për studentët shqiptarë (500 studentë) dhe një tjetër për studentët e huaj.
7. Përditësimin dhe rishikimin e rregullores së NJSBC, me qëllim përcaktimin më të qartë të fushave të veprimtarisë.

Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Master of Science in “Laboratory Technician” offered by the Higher Education Institution REALD University College

Strengths and affirmations:

1. The institution has sufficient financial stability, capacities and logistics to host a larger number of students in this study program.
2. Institutional cooperation with health institutions and medical laboratories for the development of professional practices and scientific research that students carry out during the development of diploma topics
3. Financial support for academic staff in scientific research activity by involving them in scientific projects that contribute to professional and scientific training.
4. Involvement of students in the decision-making processes of the institution for further improvement of the quality of teaching as well as their motivation through involvement in projects that the institution has.

Weaknesses:

1. Lack of medical teaching laboratories in Clinical Biochemistry, Microbiology or Histology for the development of teaching practice. *(IV.2, criterion 3)*
2. Lack of subject heads from the professor category in some subjects as well as the engagement of academic staff with Msc. in this study program. *(II.3, criterion 2)*
3. The professional expertise of some of the academic staff does not match the subjects they teach in this study program. *(IV.1, criterion 1)*

Recomandations:

1. EEG recommends recruiting academic staff with medical training in accordance with the subjects that will be developed in the curriculum, not engaging academic staff with Msc. in this study program, as well as reviewing the teaching load of academic staff (given that EAS covers 60% of the total load).
2. It is suggested that the heads of the courses be selected from the professor category and that the legal criteria be met.



3. We recommend establishing medical teaching laboratories in Clinical Biochemistry, Microbiology or Histology for the development of teaching practice in HEI facilities.
4. Reviewing the syllabi of immunology, transfusion medicine, organization, management and health promotion, as well as updating the syllabi literature in order to improve the study program (given that in some cases it is old and not contemporary).
5. EEG suggests reviewing agreements with health institutions whose cooperation period has expired.
6. It is recommended to increase the number of staff in the Career Counseling Office, which could consist of two members, one for Albanian students (500 students) and another for foreign students.
7. Updating and reviewing the regulation of the IQAU, in order to more clearly define the areas of activity.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT		X		
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	